

Qendra për demokraci ekologjike – Florozon

Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor e Republikës së Maqedonisë

**Studim i Protokollit të regjistrave të lëshimit dhe
bartjes së ndotësve në Republikën e Maqedonisë
për vitin 2014**

Shkup, dhjetor, viti 2014

Republika e Maqedonisë

Hartuesit

Botuesi:	Qendra për demokraci ekologjike – FLOROZON
Përpiloi:	Kirill Ristovski – QDE Florozon
Projekti:	“Right to Know-Right Now” – “E drejta për të ditur – tani”
Bashkëpunëtorët:	Azemine Shaqiri – MMJPH Nikolla Jakimovski – MMJPH Ivica Tasiç – MMJPH Martin Trajçev – QDE FLOROZON
QDE – Florozon:	Vizbeg, rr. 2, nr. 46, 1000 Shkup Tel.: +389 2 520 8249 e-mail-i: contact@florozon.org.mk
	Shkup, dhjetor, viti 2014 Republika e Maqedonisë



Përmbajtja

Lista e web faqeve të përdorura.....	6
Lista e literaturës së përdorur	6
Lista e shkurtimeve	7
Parathënie.....	9
Hyrje.....	10
Pasqyra historike	11
Deklarata e Stokholmit.....	12
Deklarata e Rios	13
Konventa e Aarhusit.....	15
MOP-i i jashtëzakonshëm	16
RLBN – Vegël e fuqishme në angazhimet për pakësimin e rreziqeve nga ndotja	17
Hyrje	17
Vendosja e sistemeve të para RLBN.....	19
Inventari i emetimeve toksike i SHBA-ve (TRI–Toxic Releases Inventories of the USA).....	19
Inventari holandez i emetimeve individuale dhe kolektive	19
Inventari i emetimeve kimike i Mbretërisë së Bashkuar.....	20
Përparësitë e sistemeve RLBN	21
Shfrytëzimi i informacioneve RLBN nga Qeveria.....	21
Dobia nga sistemet RLBN për industrinë.....	22
Avantazhet për industrinë.....	23
Dobia për publikun.....	23
Avantazhet për publikun.....	23
RLBN Evropian (E-RLBN).....	24
Hyrje	24
Përfshirja e E-RLBN	25
E-RLBN dhe Direktiva PKIN	26
Konventa e Aarhusit dhe Protokollit RLBN.....	27
Si funksionon Protokollit?.....	28
Përmbajtja e Protokollit të RLBN-së.....	29
Materjet ndotëse të përfshira me RLBN	30
Kush raporton?	32
Zbatimi i Protokollit RLBN në RM.....	35
Historia.....	35
Harmonizimi i legjislacionit të brendshëm me kërkesat e Protokollit RLBN.....	35
Forma, metodologjia dhe mënyra e mbajtjes së regjistrit	38
Forma dhe përmbajtja e Regjistrit	38
Mbajtja e regjistrit dhe identifikimi i impianteve RLBN	40
Obligimet dhe cikli i raportimit.....	41
Metodat për përcaktimin e lëshimit	42
Cilësia e të dhënave.....	43
Prezantimi i të dhënave	44
Dispozitat ndëshkuese të parapara me Ligjin mbi Mjedisin Jetësor të Republikës së Maqedonisë...	45
Aktivitetet e ardhshme për implementimin e Protokollit RLBN në Republikën e Maqedonisë	47
Zhvillimi i kornizës institucionale	47
Fuqizimi i kapaciteteve administrative në administrimin e mjedisit jetësor	48

Zhvillimi i veglave elektronike	49
Diseminimi i të dhënave	50
Bashkëpunimi me organizatat joqeveritare dhe vepruesit tjerë	50
S H T O J C A I	53

Lista e web faqeve të përdorura

www.moepp.gov.mk
www.prtr.net
www.unece.org
www.unitar.org
www.un.org
www.epa.gov
www.gov.uk
www.emissieregistratie.nl
<http://prtr.ec.europa.eu>
www.slvesnik.com.mk
www.unep.org
www.oecd.org

Lista e literaturës së përdorur

- UNITAR Guidance Series for Implementinga National PRTR Design Project;
Implementing a National PRTR Design Project - A Guidance Document,
- European Commission (2006),
Guidance Document for the Implementation of the European PRTR
- UNECE (2008), *Guidance on Implementation of the Protocol on Pollutant Release and Transfer Registers*, United Nations, New York and Geneva,
- UNECE (2011a), *Your Right to a Healthy Community: A simplified guide to the Protocol on Pollutant Release and Transfer Registers*, UNECE, Geneva,

Lista e shkurtimeve

RLBN – Regjistri i lëshimeve dhe bartjes së ndotësve

UNECE – United Nations Economic Commission for Europe (Komisioni Ekonomik i Kombeve të Bashkuara për Evropën)

UNITAR – United Nations Institute for Training and Research (Instituti i Kombeve të Bashkuara për Trajnim dhe Hulumtim)

MOP – Meeting of the Parties (Takimi i palëve)

OECD – Organisation for Economic Co-operation and Development (Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim)

SHBA – Shtetet e Bashkuara të Amerikës

TRI – Toxics Release Inventory (Inventari i Lëshimeve Toksike)

E-RIPZ – Regjistri Evropian i Lëshimeve dhe Bartjes së Ndotësve

EFTA – European Free Trade Association (Shoqëria Evropiane për Tregti të Lirë)

KA – Konventa e Aarhusit

CAS – Chemical Abstract System (Sistemi abstrakt kimik)

BE – Bashkimi Evropian

REReP – Programi Rajonal për Rikonstruimin e Ambientit Jetësor në Evropën Juglindore

MMJPH – Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor

SIGJ – Sistemi Informativ Gjeografik

LCP – Large Combustion Plant (Impiant i Madh i Djegies)

OJQ – Organizatë Joqeveritare

UNCED – Konferenca e Kombeve të Bashkuara mbi Mjedisin Jetësor dhe Zhvillimin

UNEP – Programi i Kombeve të Bashkuara për Mjedisin Jetësor

PKIN – Parandalimi dhe kontrolli i integruar i ndotjes



Parathënie

Ky studim është pjesë e Projektit “E drejta për të ditur-tani!” është përpiluar nga Qendra për Demokraci Ekologjike FLOROZON, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor e Republikës së Maqedonisë.

Objektivi i këtij dokumenti është të bëjë rishikimin e zhvillimit të Protokollit RLBN dhe implementimi i tij në botë, Evropë dhe në Republikën e Maqedonisë, si dhe të jep udhëzime për përmirësimin e funksionimit të tij në nivelin kombëtar.

Në kuadër të Projektit, përveç përpilimit të këtij studimi po bëhet dhe përmirësimi praktik i funksionimit të Protokollit në bashkëpunim me Ministrinë kompetente.

Studimi dhe aktivitetet tjera të parashikuara me Projektin janë përpiluar dhe po zhvillohen për të mundësuar implementimin e plotë të Protokollit RLBN dhe është menduar si për operatorët (ndotësit), ashtu dhe për vendimsjellësit dhe publikun e gjerë.

Kirill Ristovski,
Kryetar
QDE Florozon



Hyrje

Sundimi i mirë dhe administrimi i mjedisit jetësor në nivelin kombëtar dhe ndërkombëtar ka domethënie esenciale për zbatimin e politikës së mirë shtetërore. Transparenca, llogaridhënia, e drejta për qasje në informacione dhe pjesëmarrja e publikut në vendimsjellje paraqiten të jenë vegla të cilat po fuqizojnë proceset demokratike në vendet në tranzicion dhe zhvillimin, me qëllim sigurimi i sundimit të mirë. Kjo vlen për të gjitha politikatat, përfshirë këtu dhe politikatat e mjedisit jetësor, të cilat janë ndër fushat më të prekshme në shoqëri.

Njëra nga sfidat kryesore me të cilat po përballemi në ditët tona është mbrojtja e mjedisit jetësor dhe resurseve natyrore. Gjegjësisht industrializimi i përsheptuar i më tepër rajoneve të botës çoi drejt hapjes së një numri të stërmadh të fabrikave, të cilat, për nevojat e procesve të veta të prodhimit shfrytëzojnë lëndë të para dhe materiale të natyrshme të cilat vazhdimisht po degradojnë mjedisin jetësor. Proceset e këtilla të prodhimit gjenerojnë dhe emetojnë një sasi të konsiderueshme të materialeve dhe substancave të dëmshme në dhe, ujë dhe ajër, ndërsa pasojat e ndotjes së këtillë janë shkatërrimtare për shëndetin e njeriut.

Të përballura me rreziqet e ndotjes disashekullore dhe të vetëdijshme për pasojat e saj, vendet e lartë-zhvilluara gjatë dy dekadave të fundit po marrin iniciativa me të cilat po bëhen përpjekje për zbatimin konzistent të parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm¹. Këto iniciativa më së shpeshi mishërohen në një legjislacion ndërkombëtar, i cili, nëpërmjet të mekanizmave nga më të ndryshmet, zbatohet në nivelin shtetëror, apo lokal.

Kështu, në bazë të Agjendës 21, të miratuar gjatë Samitit Botëror të Planetit Tokë, mbajtur në vitin 1992 në Rio de Zhaneiro, në deklaratën përfundimtare, të miratuar nga 150 vende, është shënuar qartë se “qeveritë dhe organizatat relevante ndërkombëtare, në bashkëpunim me industrinë, duhet përmirësuar bazën ekzistuese të të dhënave mbi emetimet e materjeve toksike ose të zhvillojnë një sistem informimi në formë të regjistrit”.

Një dekadë më vonë, në Kiev (maj, viti 2003), vendet e rajonit UNECE² gjatë takimit të jashtëzakonshëm të Palëve të Konventës së Aarhusit, miratuan Protokollin e regjistrave të ndotësve dhe të bartjes së materjeve ndotëse.

Protokolli paraqet një vegël cilësore e cila siguron qasje në informacione për publikun (të brendshëm dhe ndërkombëtar), pushtetin lokal dhe qendror, si dhe për organizatat dhe institucionet ndërkombëtare dhe ai mundëson dhe një ndotje të përgjegjshme nga kapacitetet industriale, duke nxitur zhvillimin e mëtejshëm të politikave ekologjike kombëtare, të bazuara mbi parimin “ndotësi paguan”.

[1] http://www.unep.org/training/programmes/Principles_%20of_Sustainable_Development.pdf

[2] <http://www.unece.org/oes/nutshell/ecemap.html>



Pasqyra historike

Kemikaljet dhe substancat kimike janë pjesë përbërëse të përditshmërisë dhe është evidente dhe varësia (materiale dhe ekonomike) e përdorimit të tyre nga njeriu. Në kushte të tempos së përsheptuar të zhvillimit industrial, shoqëria rregullon dhe drejton mënyrën e përdorimit të tyre. Qasja e integruar gjatë drejtimit të këtyre substancave ka rëndësi vendimtare për çdo shoqëri, duke marrë parasysh pasojat e mundshme të padëshiruara për shëndetin e njeriut dhe për natyrën, të shkaktuar nga përdorimi i pakontrolluar të tyre.

Koncepti i drejtimit të integruar dhe i parandalimit të rreziqeve nga efektet e padëshiruara të substancave kimike është identifikuar në planin ndërkombëtar që para disa dekadave, kur për shkak të mungesës së “rregullave të lojës” të stipuluara, u shfaqën avari industriale, të cilat ishin të kobshme për jetat e mijëra njerëzve.

Fillet zyrtare institucionale të angazhimit global për mbrojtjen e mjedisit jetësor datojnë që nga viti 1972 kur në Stokholim, Kombet e Bashkuara organizuan konferencën e parë ndërkombëtare, gjatë së cilës u identifikuan problemet me mbrojtjen e mjedisit jetësor.

Objekti i kësaj konference ishte të ndërpritet praktika e deriatëhershme për të sjell vendime globale nga vende individuale dhe të futet në përdorim mekanizmi i vendimsjelljes nëpërmjet të bashkëpunimit ndërkombëtar.

Megjithatë, momenti i vërtetë historik në politikën ndërkombëtare për mjedisin jetësor është Samiti Botëror i Planetit Tokë mbajtur në Rio de Janeiro në periudhën nga 3 deri 14 qershor të vitit 1992. Gjatë Samitit, në të cilin morën pjesë 176 vende, si dhe Bashkësia Ekonomike Evropiane (më vonë Bashkimi Evropian), janë miratuar disa tekste lidhur me mjedisin jetësor dhe zhvillimin e qëndrueshëm, në mesin e të cilave dhe **Deklarata e Rios³** dhe **Agjenda 21⁴**.

Këto dy dokumente historike do të çojnë drejt zhvillimit të mëtejshëm të vazhdueshëm të politikës ekologjike ndërkombëtare dhe do ta vendosin kornizën me të cilën do të rregullohen “rregullat e lojës” në raport me mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe parandalimin e rreziqeve të ndotjes.

Deklaratat e Stokholmit dhe Rios janë dokumentet vendimtare që kanë dalë nga konferenca e parë dhe e dytë globale mbi mjedisin jetësor.

Politikat ose instrumentet juridike që janë shfaqur në planin ndërkombëtar pas këtyre konferencave, siç janë Korniza e Veprimit Ekologjik në Stokholm dhe Agjenda 21, në Rio, janë të lidhura ngushtë me dy deklaratat si konceptuale, ashtu dhe politike. Megjithatë, deklaratat, në mënyrën e vet, paraqesin një sinjal për arritje ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes së mjedisit jetësor dhe shëndetit të njeriut.

Të miratuara në një divergjencë njëzet-vjeçare, ata padyshim paraqesin pikëkthesa të mëdha në evoluimin e së drejtës ndërkombëtare ekologjike, e cila paraqet një uvertirë në “erën moderne”. “Stokholmi” paraqet një thyerje e akullit dhe për herë të parë çon drejt ndërmarrjes së veprimeve globale që kanë të bëjnë me

[3] <http://www.unep.org/Documents.Multilingual/Default.asp?documentid=78&articleid=1163>

[4] <http://www.unep.org/Documents.Multilingual/Default.asp?documentid=52>



ndikimin e njeriut mbi mjedisin jetësor, si dhe një përpjekje për një perspektivë të përbashkët për atë se si duhet përgjigjur sfidës së ruajtjes dhe avancimit të ambientit të njeriut.

Si rezultat i kësaj, Deklarata e Stokholmit definon objektiva të gjera të politikës së mjedisit jetësor pa vendosur pozita normative të detajuara. Megjithatë, pas Stokholmit, vetëdija globale mbi problemet ekologjike është ngritur vrullshëm, dhe mundëson sjellje të drejtë të vendimeve në planin ndërkombëtar. Në të njëjtën kohë, fokusi i aktivizmit ekologjik ndërkombëtar gradualisht është zgjeruar dhe në sferën e çështjeve ekologjike ndërkufitare dhe globale me interes të përbashkët, si dhe në rregullativën ndërsektoriale, duke sintetizuar me këtë dhe faktorët ekonomik dhe zhvillimor në sjelljen e vendimeve.

Kështu, gjatë Konferencës në Rio, detyra e komunitetit ndërkombëtar ishte t'i sistematizojë dhe riekzaminonjë pritjet normative ekzistuese në lidhje me mjedisin jetësor, si dhe të vendos baza juridike dhe politike në zhvillimin e qëndrueshëm.

Në këtë drejtim, UNCED është e obliguar të hartojë një Deklaratë, me të cilën do të rregullohen të drejtat dhe obligimet për mjedisin jetësor dhe zhvillimin, në bazë të **Kartës Botërore**⁵ mbi natyrën, të sjellë nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në vitin 1982.

Edhe pse propozim-teksti i harmonizuar i Deklaratës, i miratuar në Rio nuk mund të konsiderohet si një dokument superior, gjatë dy dekadave të ardhshme u imponua si udhërrëfyese kryesor dhe forca lëvizëse e zhvillimit të politikës ndërkombëtare mbi mjedisin jetësor.

Deklarata e Stokholmit

Konferenca e Kombeve të Bashkuara mbi ambientin e njeriut është konferenca e parë ndërkombëtare e cila fokusohet në çështjet e mbrojtjes së mjedisit jetësor në planin ndërkombëtar.

Konferenca e mbajtur në Stokholm në qershor të vitit 1972, nën preionin e rritjes intensive të arsenalit nuklear në suaza globale dhe me industrializim të pakontrolluar, reflekton interesin gjithnjë e më të madh për konservimin e mjedisit jetësor dhe administrimi i tij ndërkombëtar.

Në konferencë morën pjesë delegacione nga 114 qeveri, përderisa Bashkimi Sovietik bojkotonte këtë ngjarje për arsye të përjashtimit të Gjermanisë Lindore e cila në atë kohë nuk ishte anëtare e KB-ve.

Dokumentet kryesore që kanë dalë nga konferenca janë **Deklarata**⁶ dhe **Korniza për Veprim Ekologjik**⁷. Deklarata që është miratuar në këtë konferencë paraqet një “manifest ekologjik” i llojit të vet, i cili qartë referon nevojën për mbrojtjen e natyrës dhe resurset e saja nga ana e njeriut. Mes tjerash, ajo vendos lidhjen midis të drejtave bazë të njeriut dhe mjedisin jetësor. Deklarata përbëhet nga 26 parime, të cilat japin udhëzime dhe rekomandime në kuptimin e mbrojtjes së natyrës dhe resurseve të saja.

Parimi i parë fillon me “Njeriu ka të drejtën bazë për liri, barazi dhe kushte përkatëse për jetesë në një mjedis jetësor, cilësia e të cilit siguron dinjtet dhe mirëqenie.”

Me parimet tjera Deklarata thekson lidhjen e zhvillimit ekonomik me mbrojtjen e mjedisit jetësor. Pikërisht, parimi 8 thekson se “zhvillimi nevojitet për avancimin e ambientit jetësor”, përderisa parimi 11 thekson se “politikat ekologjike nuk guxojnë të pengojnë zhvillimin.”

[5] Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme 37/7

[6] <http://www.unep.org/Documents.Multilingual/Default.asp?documentid=97&articleid=1503>

[7] <http://www.un-documents.net/aconf48-14r1.pdf>



Temat tjera kryesore që janë trajtuar me Deklaratën janë:

- Nevoja për konservimin dhe mbrojtjen e qenieve të egra dhe vendbanimeve të tyre (Parimi 4);
- Shmangia e ndotjes së detërave (Parimi 7);
- Shfrytëzimi i resurseve që nuk janë të ripërtëritshme (Parimi 5);
- Rëndësia e zhvillimit të planifikimit të koordinuar (Parimet 13-17);
- Rëndësia e arsimimit mbi mjedisin jetësor (Parimi 19);
- Lehtësimi i hulumtimeve shkencore dhe i qarkullimit të lirë të informacioneve (Parimi 20);
- Zhvillimi i së drejtës ndërkombëtare në lidhje me ndotjen dhe dëmeve ekologjike (Parimi 22);
- Mënjanimi dhe asgjësimi i armës nukleare (Parimi 26).

Korniza për Veprim Ekologjik paraqet një plan veprimi për zbatimin e Deklaratës në praktikë, e cila përmban 109 rekomandime konkrete lidhur me vendbanimet njerëzore, me administrimin e resurseve njerëzore, ndotjes, aspekteve sociale dhe arsimore të mjedisit jetësor, zhvillimin e organizatave ndërkombëtare.

Në kontekstin e këtij të fundit, përveç Deklaratës, në këtë konferencë po formohet një organ i posaçëm në kuadër të Kombeve të Bashkuara - (UNEP – United Nations Environmental Program – Programi i Kombeve të Bashkuara mbi Mjedisin Jetësor), roli i të cilit kryesor është t'i koordinojë përpjekjet globale për promovimin e qëndrueshmërisë dhe mbrojtjes së mjedisit jetësor.

Pavarësisht nga e lartëpërmendura, në vitet vijuese, çështjet dhe problemet me mjedisin jetësor janë vënë në plan të dytë dhe qendra e vëmendjes është drejtuar kah raportet politike midis fuqive botërore. Në kushte të këtilla, procesi i industrializimit merr përjetën e vet, duke mos marrë në konsideratë rekomandimet e konferencës në Stokholm.

Disa vite më pas ndodhin disa fatkeqësi ekologjike (Çernobilli, Bapna, etj.), të cilat shkaktojnë pasoja të paparashikueshme për mjedisin jetësor dhe shëndetin e njeriut, të cilat po ndjehen dhe sot.

Deklarata e Rios

Njëzet vjet pas mbajtjes së konferencës në Stokholm, bota vazhdoi të përballlet me sfidat e degradimit afatgjatë të sistemeve eko, dheut dhe humbjes së biodiversitetit, ndotjes së atmosferës dhe efekteve të ndryshimeve klimatike, ndotjes së pellgjeve ujore, ndikimit të kemikaljeve dhe trajtimi i tyre, mbeturinave dhe shfrytëzimit të resurseve që nuk janë të ripërtëritshme. Njëkohësisht po ndodhin dhe rënia e Murrit të Berlinit dhe ngritja e të ashtuquajturës “perde e hekurt” duke në frymën e parimeve demokratike të sundimit, imponohet nevoja për definimin e rolit të individit në shoqëri nëpërmjet të inkuadrimit të saj në procesin e sjelljes së vendimeve.

Në këtë drejtim, Kombet e Bashkuara, në bazë të Rezolutës 44/228 po fillojnë përgatitje për organizimin e konferencës ndërkombëtare, e cila ka për qëllim të bëjë “pajtimin” midis zhvillimit ekonomik dhe mbrojtjes së mjedisit jetësor. Konferenca e Kombeve të Bashkuara mbi Mjedisin Jetësor dhe Zhvillimin (e pranuar ndërkombëtarisht si Samit i Planetit Tokë) po mbahet në qershor të vitit 1992 në Rio de Zhaneiro të Brazilit.



Në Samit, i cili paraqiste një mbledhje nga më të mëdhatë e shënuar në historinë e njerëzimit, të zyrtarëve shtetëror në një vend të vetëm, marrin pjesë gjithsej 117 krerë të shteteve dhe 178 delegacione të shteteve. Me ndihmën e marrëveshjeve dhe dokumenteve tjera strategjike të nënshkruara në Konferencë, shumica e vendeve të botës qëndruan pas qëndrimeve për mundësimin e zhvillimit ekonomik në mënyrë me të cilën do të sigurohej mbrojtja përkatëse e mjedisit jetësor dhe resurseve natyrore që nuk janë të ripërtëritshme. Dokumentet kryesore që janë miratuar në këtë Samit janë:

Konventa e shumëllojshmërisë biologjike⁸ - marrëveshje kjo detyruese nëpërmjet të së cilës vendet duhet futur në përdorim një regjistër të bimët e tyre dhe kafshët e egra, duke siguruar mbrojtjen e gjithë specieve/racave të rrezikuara;

Konventa Kornizë e ndryshimeve klimatike⁹ - marrëveshje kjo detyruese e cila kërkon nga vendet të pakësojnë emetimet e dyoksidit të karbonit, metanit dhe gazrave tjera të serrave që janë përgjegës për ngrohjen globale.

Deklarata mbi Mjedisin Jetësor dhe Zhvillimin, e konceptuar mbi bazat e Deklaratës së Stokholmit, paraqet një vazhdim të llojit të vet, duke vënë theksin në mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe zhvillimit të qëndrueshëm, nëpërmjet të sjelljes së vendimeve nga individit brenda shoqërisë. Ky dokument përmban 27 parime që kanë të bëjnë me administrimin e integruar gjithëpërfshirës të mjedisit jetësor dhe zhvillimit të qëndrueshëm.

Parimet 10 dhe 14 kanë rëndësi të jashtëzakonshme, si për zhvillimin e Protokollit të regjistrave të ndotësve dhe bartjes së materjeve ndotëse, ashtu dhe për zhvillimin e së ashtuquajturës demokraci ekologjike, gjegjësisht, sigurimi i qasjes në informacione për publikun, pjesëmarrja e tij në procesin e sjelljes së vendimeve dhe e drejta e tyre për drejtësi në rast të shkeljes së njëres nga dy drejtat e përmendura më lartë.

Agjenda 21 paraqet një dokument i cili thekson angazhimet globale për mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe për nxitjen e zhvillimit në mënyrë të qëndrueshme.

Është ky një plan veprimi i përbërë nga dyzetë pikë, të ndara në katër kapituj që marrin parasysh dimensionet socio-ekonomike, konservimin dhe administrimin e resurseve të nevojitura për zhvillimin, rolin e grupeve kryesore të vepruesve, si dhe fuqizimin e tyre dhe mjeteve për implementimin e planit.



Konventa e Aarhusit

Kofi Anan, Sekretar i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara (1997-2006)

“...Miratimi i Konventës së Aarhusit paraqet një hap gjigant drejt zhvillimit të së drejtës ndërkombëtare në këtë fushë ... Edhe pse rajonale në volum, domethënia e Konventës së Aarhusit është globale. Ajo paraqet një elaborim larg më impresiv i parimit 10 të Deklaratës së Rios... si e tillë, ajo paraqet projektin më ambicioz në fushën e “demokracisë ekologjike” të nisur nga Kombet e Bashkuara...”

Kjo Konventë paraqet një marrëveshje multilaterale midis vendeve të rajonit UNECE dhe evoluimi i saj fillon në periudhën pas miratimit të Deklaratës së Rios. Gjegjësisht, siç është theksuar më lartë, kjo Deklaratë është përbërë nga 27 parime të cilat në mënyrë të qartë dhe të njëkuptimshme tregojnë për nevojën e sjelljes së marrëveshjeve detyruese, nëpërmjet të të cilave do të realizohen objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm dhe të mbrojtjes së mjedisit jetësor.

Duke u nisur nga Parimi 10, organizata e UNECE filloi përgatitjet për zbatimin e “demokracisë ekologjike” në praktikë, me ndihmën e institucionalizimit të saj.

Kështu, në vitin 1995 në Sofje, R. e Bullgarisë, u miratua udhëzimi mbi qasjen në informacione mbi mjedisin jetësor dhe mbi pjesëmarrjen e publikut në vendim sjellje.

Konventa UNECE¹⁰ për qasje në informacione, pjesëmarrje të publikut në procesin e vendim sjelljes dhe qasje në drejtësi lidhur me çështje nga mjedisi jetësor është miratuar më 25 qershor të vitit 1998 në Aarhus të Danimarkës, gjatë Konferencës së katërt Ministeriale, nën patronazhin e UNECE, si pjesë e procesit “Mjedisi jetësor për Evropën”. Ajo hyn në fuqi më 30 tetor të vitit 2001 dhe për momentin ka 44 palë (vende nënshkruese), duke përfshirë këtu dhe Bashkimin Evropian.

Republika e Maqedonisë ishte në mesin e vendeve të para nënshkruese dhe pas ratifikimit të Konventës nga Kuvendi i RM-së, ka filluar procesi i harmonizimit të kornizës ligjore.

Konventa e Aarhusit mbështetet mbi tre shtylla kryesore dhe garanton të drejtat e qasjes në informacione (shtylla e parë), pjesëmarrja e publikut në procesin e sjelljes së vendimeve (shtylla e dytë) dhe qasja në drejtësi (shtylla e tretë) në fushën e mjedisit jetësor, me qëllim dhënia e kontributit për mbrojtjen e së drejtës së çdo idividi nga gjeneratat aktuale dhe të ardhshme që të jetojnë në një mjedis të përshtatshëm për shëndetin dhe mirëqenien e tij ose të saj dhe (Neni 1).

Sipas Konventës, nga palët kërkohet, mes tjerash, që ta promovojnë aplikimin e parimeve të Konventës së Aarhusit në proceset ndërkombëtare të sjelljes së vendimeve mbi mjedisin jetësor dhe në kuadër të organizatave ndërkombëtare lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me mjedisin jetësor (Neni 3, paragrafi 7).

[10] <http://www.unece.org/environmental-policy/treaties/public-participation/aarhus-convention.html>



Takimi i palëve (Meeting of Parties ose MOP): Seanca e parë e MOR u mbajt në Lluka të Italisë në tetor të vitit 2002, ku u miratuan:

- Deklarata Lluka¹¹;
- Udhëzimi mbi qasjen në informacione, pjesëmarrjen e publikut dhe qasjen në drejtësi në lidhje me organizmat e modifikuar gjenetikisht (GMO)¹²;
- Rregullorja e punës¹³; dhe
- Vendimi¹⁴ nëpërmjet të cilit kërkohet hartimi i një instrumenti juridik detyrues në formë të Protokollit të regjistrave për lëshimin dhe bartjen e materjeve ndotëse (RLBN).

Gjatë këtij takimi është formuar dhe Grupi i Palëve i Punës, me detyrë që ta vëzhgojë zbatimin e Programit të Punës së Konventës, t'i përgatit seancat e MOP dhe t'i vëzhgojë aktivitetet e organeve ndihmëse të themeluara nga MOR, apo përkatësisht:

- Grupin e punës për qasje në drejtësi;
- Grupin e punës për veglat elektronike të informacioneve; dhe
- Grupin e punës për rregullimet financiare.

MOP plotësueshëm formon Komisionin e Ankesave në pajtim me Konventën e Aarhusit (Neni 15), me të cilin përcaktohet struktura, funksionet dhe procedurat e saja.

MOP-i i jashtëzakonshëm

Seanca e jashtëzakonshme e MOP-it u mbajt më 21 maj të vitit 2003 në Kiev të Ukrainës, në kuadër të Konferencës së pestë Ministeriale, si pjesë e procesit “Mjedisi jetësor për Evropën”. Gjatë këtij MOP-i u miratua Protokollin i regjistrave për lëshimin dhe bartjen e ndotësve.

[11] <http://www.unece.org/fileadmin/DAM/env/pp/documents/mop1/ece.mp.pp.2.add.1.e.pdf>

[12] <http://www.unece.org/fileadmin/DAM/env/pp/documents/gmoguidelinesenglish.pdf>

[13] <http://www.unece.org/fileadmin/DAM/env/pp/documents/mop1/ece.mp.pp.2.add.2.e.pdf>

[14] <http://www.unece.org/fileadmin/DAM/env/pp/documents/mop1/ece.mp.pp.2.add.3.e.pdf>



RLBN – Vegël e fuqishme në angazhimet për pakësimin e rreziqeve nga ndotja

Hyrje

Zhvillimi i përshpejtuar historik i disa rajoneve të botës çoi drejt rritjes së konsiderueshme të prodhimit dhe përdorimit të kemikaljeve në kuadër të proceseve prodhuese dhe rezultoi me emetime të rritura të substancave kimike në ajër, dhe dhe ujë, duke akumuluar rezerva të mëdha të mbeturinave kimike.

Në këtë proces të ndotjes, pjesa më e madhe e punonjësve, organeve shtetërore, autoriteteve dhe strukturave drejtuese nuk ishin të vetëdijshëm se këto emetime shkaktojnë pasoja të përhershme jo vetëm për mjedisin jetësor, por dhe për shëndetin e njeriut.

Të vetëdijshëm për rreziqet e proceseve të këtilla, disa vende perëndimore të lartë-zhvilluara, siç janë SHBA-të, Kanada, Britania e Madhe dhe Holanda kanë futur në përdorim regjistra të emetimeve të kemikaljeve, për të paralajmëruar rreth rreziqeve të ndotjes nga materjet toksike në çdo vend veçanërisht. RLBN paraqet një katalog ose regjistër i materjeve lartë-ndotëse të cilat lëshohen nga impiantet ndotëse në ajër, dhe ose ujë dhe ato transmetohen nga njëri pozicion në tjetrin me mjete transporti. Regjistri mundëson rishikimin e informacioneve mbi natyrën dhe sasitë e materjeve ndotëse të lëshuara ose të transportuara/të deponuara nga ndotësi në njërin nga mediat ekologjike (dhe, ajër ose ujë).

Disa dekada më vonë, duke marrë parasysh përvojat pozitive nga këto regjistra, nën patronazhin e Kombeve të Bashkuara futet në përdorim Protokoll i regjistrave të ndotësve dhe bartjes së materjeve ndotëse (RLBN).

Domethënë, në vitin 1994, Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD – Organization for Economic Co-operation and Development), nëpërmjet të Grupit të vet të Punës për kontroll dhe parandalim të ndotjes, përgatiti udhëzuesin¹⁵ e parë, qëllimi i të cilit ishte ta lehtësojë formimin dhe implementimin e RLBN në vendet anembanë botës.

Ky udhëzues u përpilua në bazë të përvojave pozitive të vendeve të numëruara më lartë, të cilat me iniciativën e vet aplikuan sistemet RLBN. Përkundër interesimit të dobët të shumicës së vendeve dhe paralelisht me punën e OECD-së, Instituti për Hulumtim dhe Trajnime pranë Kombeve të Bashkuara (UNITAR¹⁶), inicoi zbatimin e projekteve pilot RLBN në Meksikë, Egjipt dhe Çeki. Qëllimi i këtyre projekteve ishte të ndihmohet secili vend individualisht në projektimin e sistemit kombëtar RLBN me ndihmën e një procesi konsultativ midis Qeverisë, industrisë dhe organizatave joqeveritare.

Këto dy organizata ndërkombëtare, me aktivitetet e tyre gjatë periudhës së njëjtë kohore dhe në zona të ndryshme të botës, imponuan konceptin RLBN si një vegël jashtëzakonisht të rëndësishme për parandalimin e ndotjes jo vetëm në vendet lartë të industrializuara, por dhe në vendet në zhvillim.

Siç theksuam më lartë, RLBN paraqet një katalog ose regjistër i materjeve ndotëse të cilat po emetohen në njërin nga mediat ekologjike ose transmetohen nga njëri pozicion në tjetrin, duke përfshirë këtu dhe informacionet mbi natyrën dhe sasitë e substancave kimike. Gjithashtu, RLBN mundëson informacione rreth vendndodhjes së ndotjes (si për shembull fabrika), ose burimi difuziv i ndotjes, siç janë aktivitetet bujqësore ose transporti.

Zakonisht, RLBN përfshin emetimet e elementeve të dëmshme në ajër, dhe dhe ujë, por dhe pi-

[15] <http://www.oecd.org/chemicalsafety/pollutant-release-transfer-register/>

[16] <http://www.unitar.org/cwm/prtr>



kat ku magazinohen mbeturinat e transportuara. Për dallim nga sistemet “tradicionale” për vëzhgimin e ndotjes, me të cilët jepet pasqyra e emetimeve të “gazrave të serrave” ose emetimeve të “metaleve të rënda”, sistemet RIPZ japin pasqyrën e emetimeve të substancave ose elementeve specifike vetanake (siç është për shëmbull benzeni ose zhiva), për çdo ndotës individualisht. Veç kësaj, RLBN mundëson:

- Raporte mbi emetimet në nivel vjetor;
- Listën e përbashkët të referencave të elementeve ndotëse, e cila mundëson një rishikim krahasues të ndotjes nga më shumë instalime;
- Digjitalizimin e informacioneve dhe pasqyra e tyre grafike;
- Disponueshmërinë e informacioneve për tërë publikun e brendshëm dhe atë ndërkombëtar.

Duke marrë parasysh se katër veçoritë kryesore të RLBN-së, mund të konstatohet se ky sistem është vegël e cila mundëson zbatimin e politikave efikase dhe efektive në drejtim të mbrojtjes së mjedisit jetësor dhe zhvillimit të qëndrueshëm, me ndihmën e informimit adekuat dhe përfshirjes së publikut. Në periudhën gjatë viteve të hershme të nëntëdhjeta, kur, me rekomandimet e Deklaratës së Rios dhe Agjendës 21, organizatat ndërkombëtare filluan aktivitete për të vendosur një kornizë globale për RLBN, dhe u vendosën disa parime bazë universale për zhvillimin e këtij sistemi, të cilat vlejné dhe në ditët tona:

- Sistemet RLBN duhet mundësuar informacione të cilat do të shërbejnë si mbështetje në parandalimin e rreziqeve potenciale për shëndetin e njeriut dhe mjedisin jetësor, nëpërmjet të identifikimit të burimit të ndotjes, volumit dhe përbërjes së tij;
- Informacionet e marra nga sistemi RLBN duhet të përdoren për promovimin e parandalimit të ndotjes në vetë burimin e krijimit të saj, duke inkurajuar përdorimin e teknologjisë “më të pastër” në procesin e përpunimit dhe/ose prodhimit;
- Qeveritë duhet përdorur informacionet e marra nga sistemet RLBN në drejtim të vlerësimit të efikasitetit dhe efektshmërisë së politikave ekologjike të brendshme, dhe në bazë të tyre, të vendosin objektiva realiste dhe të realizueshme;
- Në lidhje me mbushjen e bazës RLBN me informacione, duhet aplikuar mekanizma detyruese dhe vullnetare për raportim, me qëllim arritja e objektivave të Protokollit RLBN;
- Me qëllim reduktimi i raportimit të dyfishitë dhe përsëritja e raporteve, sistemet RLBN duhet të integrohen deri në shkallë të qenit praktik, ku do të ishin përdorur informacione tanimë të disponueshme, siç janë për shëmbull, lejet e integruar, e ngjashëm;
- Procesi i plotë i vendosjes së sistemit RLBN duhet qenë plotësisht transparent dhe objektiv;
- Gjatë krijimit të sistemit RLBN, qeveritë duhet të bashkëpunojnë me gjithë palët e interesuara në shoqëri dhe me këtë t’i vendosin objektivat dhe prioritetet kombëtare në bazë të vlerësimit të shpenzimeve dhe përfitimeve potenciale nga raportimi i industrisë, Qeverisë dhe shoqërisë së përgjithshme;
- Informacionet e përmbledhura në sistemin RLBN duhet qenë të diseminuara gjërësisht dhe të vëna në dispozicion publik jo vetëm për palët e interesuara, por dhe më gjerë.



Vendosja e sistemeve të para RLBN

Në vazhdim janë numëruar tre shembuj që paraqesin një nga sistemet e para RLBN të vendosura në botë.

Inventari i emetimeve toksike i SHBA-ve (TRI–Toxic Releases Inventories of the USA)

Inventari¹⁷ i emetimeve toksike i SHBA-ve është formuar në vitin 1986, për të grumbulluar informacione mbi emetimet toksike në mjedisin jetësor nga industria, duke bërë këto informacione të disponueshme për publikun.

Në pajtim me kërkesat e raportimit të TRI, instalimet që përdorin sasi më të mëdha të kemikaljeve po obligohen të përpilojnë një raport vjetor, në të cilin do të shënohen sasitë e kemikaljeve të lëshuara ose të sasive të kemikaljeve të transportuara/deponuara/të ricikluara deri/në/mbi një destinacion të caktuar.

Ky raport, në formë të standardizuar i parashtrohet Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit Jetësor të SHBA-ve, i cili mundëson një inspektim transparent në të. Duke patur parasysh zhvillimin e vetëdijes tek gjithë vepruesit në shoqëri, kërkesat dhe standardet e raportimit në TRI ndryshojnë me kalimin e viteve. Kështu, për shembull, deri në vitin 1995, lista e kemikaljeve me të cilën duhet të raportohet mbi instalimet në SHBA, përbëhet nga rreth 320 elemente/përbërje, ndërsa sot e njëjta listë është zgjeruar në më se 600. Për çdo kemikalje veçanërisht, instalimet duhet siguruar informacion mbi sasitë e emetimeve dhe mbi median në të cilën lëshohen ato, gjegjësisht, ajri, uji ose dheu.

Me këtë, në pajtim me kërkesat e TRI, instalimi duhet të informojë nëse ky emetim është rregulluar me leje të caktuar ose është emetim incidental.

E njëjta gjë ka të bëjë dhe me transportin dhe deponimin e materjeve toksike/mbeturinat, gjegjësisht, riciklimi i tij. Informacionet mbi emetimet merren nga vëzhgimi, matjet e brendshme të emetimeve, emetimet e deklaruar nga prodhuesi i pajisjes specifike, si dhe nga llojet e tjera të kalkulimeve.

Në bazë të informacioneve nga të gjitha raportet, Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit Jetësor e SHBA-ve përpilon një raport vjetor, i cili, me kërkesë të publikut, është i disponueshëm falas në formë të shkruar ose elektronike (me internet).

Inventari holandez i emetimeve individuale dhe kolektive

Ky inventar¹⁸ është vendosur në Holandë që në vitin 1972, për t'i identifikuar emetimet e shkaktuara nga industria, trafiku (ajror, hekurudhor, udhëtarë, e ngjashëm), në amvisërit, etj.

Me këtë inventar, emetimet industriale përcaktohen me matje të drejtpërdrejta, ndërsa vlerësimi i

[17] <http://www2.epa.gov/toxics-release-inventory-tri-program>

[18] <http://www.emissieregistratie.nl/ERPUBLIEK/bumper.en.aspx>



emetimeve tjera bëhet me aplikimin e të të ashtuquajturve faktorë emetues, të cilët bazohen mbi të dhëna statistikore për koncentrimin e automjeteve, shkallën e aktivitetit, e ngjashëm.

Mes tjerash, qëllimi i këtij sistemi është që, me ndihmën e kornizës së gjerë të matjeve të arrihen objektivat e politikave ekologjike lokale dhe kombëtare, duke:

- Përcaktuar emetimet e shkaktuara nga impiantet më të mëdha ndotëse në ajër, ujë dhe dhé;
- Bërë krahasimin e emetimeve që vijnë nga burime të ndryshme të ndotjes;
- Themeluar lidhjen e ndërsjellë të informacioneve mbi emetimet nga gjithë burimet e ndotjes, duke mundësuar me këtë pasqyrën e pozicioneve gjeografike të burimeve, me ndihmën e simulimit dhe modelimit.

Sistemi holandez përfshin mbi 700 ndotës më të mëdhenj të cilët raportojnë mbi emetimin e 900 substancave. Raportimi bëhet në bazë vullnetare, ndërsa informacionet e marra nga raportet janë të disponueshme në publik.

Veç kësaj qasjeje vullnetare të raportimin, Qeveria e Holandës kryen vëzhgimin dhe e emetimeve, të shkaktuar nga industritë me ndotje të lehtë, transportit, bujqësis, e ngjashëm. Gjithë informacionet janë të disponueshme në publik, në formë të raporteve periodike dhe vjetore, të cilat publiku mund t'i merr në mënyrë elektronike, gjegjësisht, nëpërmjet të internetit.

Inventari i emetimeve kimike i Mbretërisë së Bashkuar

Në bazë të aktit për mbrojtjen e mjedisit jetësor, të miratuar në vitin 1999, Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar në vitin 1991 po fut në përdorim një politikë rregullatore me futjen në përdorim të inventarit¹⁹ e emetimeve kimike.

Ky sistem është i decentralizuar në shtatë rajone, përderisa rreth 5000 instalime janë të obliguara të raportojnë mbi emetimet për 361 kemikalje, dhe 125 substanca izotopike, të rregulluara me aktin për thërrmijat radioaktive në vitin 1993.

Veç kësaj, ky sistem është lidhur me sistemin për parandalim dhe kontroll të integruar të ndotjes (PKIN) dhe me këtë parandalohet raportimi i dyfishtë i industrisë, si dhe mundëson verifikimin e lehtësuar të emetimeve për çdo instalim veçanërisht.

Ky regjistër përmban informacione të detajuara mbi autorizimin e instalimit, duke filluar nga studimi i ndikimit mbi mjedisin jetësor, e deri në versionin përfundimtar të lejes së integruar. Sistemi është i disponueshëm në publik dhe përmban informacione të qarta mbi koncentrimet maksimale të lejuara të elementeve kimike dhe mbi nivelin aktual të emetimeve, pavarësisht nëse ato janë të autorizuar ose incidentale.



Përparësitë e sistemeve RLBN

Njëra nga arsyet e suksesit të sistemeve RLBN është se ata mundësojnë përfitime jo vetëm për qeveritë, por gjithashtu dhe për industrinë dhe publikun. RLBN u siguron qeverive informacione të dobishme relevante, të cilat mund të shfrytëzohen për vendosjen e prioritetëve ekologjike kombëtare. Mes tjerash, industrisë i mundësohet zgjerimi i njohurive rreth joefikasitetit të proceseve prodhuese, përderisa publikut mund t'i shërbejë për ngritjen e vetëdijes publike rreth emetimeve potencialisht ndotëse, gjë kjo e cila do t'u mundësojë të ndikojnë mbi kompanitë në drejtim të pakësimit të tyre.

Shfrytëzimi i informacioneve RLBN nga Qeveria

Të dhënat e marra nga sistemi RLBN i mundësojnë Qeverisë informacione gjithëpërfshirëse për burimet e ndotjes dhe distribuimit të tyre gjeografik, emetimit ose transferrit në njërën nga tre mediat ekologjike (uji, ajri dhe dheu). Kështu, RLBN mundëson përmirësimin e vazhdueshëm të kapaciteteve dhe roli i qeverive në arritjen dhe vendosjen e objektivave ekologjike kombëtare. Këto objektiva mund të përfshijnë:

- Zhvillimi i treguesve me të cilët do të matet dhe kuantifikohet sukcesi apo dështimi i politikave për pakësimin e ndotjes;
- Thjeshtëzimi i integritetit të kushteve dhe kërkesave të shumëfishta për raportimin e ndotjes;
- Monitorimi i zbatimit të rregullativave aktuale mbi kemikaljet;
- Vendosja e kufizimeve dhe standardeve për emetime kimike;
- Vendosja e prioritetëve për pakësimin ose largimin nga përdorimi i kemikaljeve të caktuara;
- Promovimi i kontrollit dhe parandalimit të integruar nga ndotja, nëpërmjet të identifikimit të kemikaljeve në kuadër të industrisë, me qëllim aplikimi i teknologjive “më të pastra”;
- Informimi i publikut dhe mundësimi i përgjigjeve precize deri tek publiku i interesuar për ndotjen në periudhë të caktuar kohore;
- Plotësimi i kushteve dhe kërkesave ndërkombëtare për raportim mbi ndotjen, në pajtim me konventat dhe marrëveshjet ndërkombëtare.

Avantazhet për Qeverinë

- Identifikimi i burimeve që gjenerojnë substanca potencialisht të dëmshme kimike, nëpërmjet të përcaktimit të llojit të materjeve ndotëse, sasive të këtyre emetimeve, si dhe në cilën media lëshohen ato;
- Identifikimi i zonave gjeografike që janë të nënshtrueshme ndaj ndotjes;
- Sjellja e lehtësuar e vendimeve mbi prioritetet e administrimit të mjedisit jetësor;
- Matshmëria e lehtësuar e përparimit kombëtar drejt zvogëlimit të rreziqeve dhe parandalimit të ndotjes;
- Ndjekja e shkallës së zbatimit të rregullativës ekzistuese dhe plotësimi i obligimeve ndërkombëtare për raportim në kuadër të konventave dhe marrëveshjeve ndërkombëtare.

Dobia nga sistemet RLBN për industrinë

Madje dhe në kushte të mungesës së kërkesave detyruese për raportim mbi emetimet nga ana e qeverive, shumica e kompanive në vendet e lartë-zhvilluara, me iniciativën e vet kanë vendosur skema dhe programe të brendshme për matjen e emetimeve në kuadër të proceseve prodhuese; udhëheqësitë e kompanive kanë vërejtur se emetimet nuk paraqesin një problem vetëm e vetëm ekologjik – por dhe një bazë për humbje financiare.

Me përdorimin e një teknologjie “më të pastër” dhe me ri-përdorimin e mbeturinave paraprakisht të akumuluar, të gjeneruara në kuadër të prodhimit, kompanitë mund të realizojnë kursime të shpenzimeve. Si pasojë e grumbullimit sistematik të informacioneve mbi emetimet, kompanitë mund të inicojnë ndryshime në lidhje me përdorimin e kemikaljeve alternative, të cilat do të ishin më pak të dëmshme për rrethin dhe shëndetin e njeriut, mund ta përmirësojnë efikasitetin e pajisjes dhe me këtë, ta përmirësojnë prodhimin dhe t’i eliminojnë burimet fugiive dhe ato të pikëzuara të emetimit.

Mes tjerash, informacionet e siguruar nga RLBN mund të shërbejnë si katalizator i komunikimit më të mirë midis instalimit dhe publikut i cili jeton në afërsi të menjëhershme.

Me sigurimin e llogaridhënies, instalimi mund të vendos mirëbesim midis banorëve lokal dhe drejt gjithë atyre që paraprakisht nuk kanë mbështetur planet dhe iniciativat për zhvillim dhe/ose për zgjerim të impianteve prodhuese.

Me këtë, RLBN duhet shërbyer si katalizator për komunikim më të mirë dhe ndërtim të raporteve të mira midis instalimeve dhe vendeve të banuara fqinje, duke vendosur një mirëbesim të ndërsjellë.

Avantazhet për industrinë

- Identifikimi i burimeve të të ardhurave të humbura në kuadër të proceseve industriale;
- Zbatimi i kontrollit të përmirësuar të përdorimit kimik dhe efikasitetit të rritur të pajisjes prodhuese;
- Nxitja e zbatimit të skemave dhe programeve për prodhim më të pastër;
- Rritja e konkurrencës;
- Nxitja e transferrit të teknologjive në kuadër të dhe midis kompanive.

Dobia për publikun

Në pajtim me dispozitat e konventave dhe marrëveshjeve ndërkombëtare, secili që u është nënshtruar rreziqeve nga kemikaljet duhet të informohet për ato dhe si vazhdimësi, t'i jepet e drejta e zgjedhjes për nisje të një aktiviteti konkret.

Praktika në vendet e perëndimit tregon se publiku i informuar mirë mund të shërbejë si partner në sjelljen e vendimeve në mjedisin jetësor.

Punonjësit e informuar mirë mund të ndërmarrin aktivitete në lidhje me mbrojtjen shëndetësore personale, por dhe t'i mbrojnë instalimet nga avari kimike.

Publiku i informuar mirë gjithashtu mund ta vëzhgojë dhe ndjek progresin dhe efektshmërinë e politikave ekologjike.

Veç tjerave, vepruesit e interesuar, në bazë të të dhënave RLBN, mund të kërkojnë aplikimin dhe vendosjen e objektivave më të larta kombëtare ekologjike.

Nëpërmjet të këtij sistemi, mediat mund të sigurojnë të dhëna relevante për politikatat ekologjike aktuale dhe shkallën e ndotjes, të shkaktuar nga një ose më tepër ndotës në ndonjë zonë të caktuar gjeografike, ndërsa publiku akademik mund t'i shfrytëzojë këto të dhëna për qëllime shkencorë-kërkimore.

Avantazhet për publikun

- Mundësimi i së drejtës për të ditur rreth rreziqeve potenciale nga kemikaljet në bashkësi;
- Mundësimi i së drejtës së zgjedhjes dhe nisjes së veprimeve të caktuara në lidhje me ndotjen;
- Nxitja e ndërmarrjes së masave vetanake për punëtorët për vetë ata, si dhe për godinat ku punojnë, nga fatkeqësi kimike lidhur me mbrojtjen;
- Rritja e pjesëmarrjes në vendim sjellje;
- Përmirësimi i sistemit edukativ.



RLBN Evropian (E-RLBN)

Hyrje

Marrëveshja e fundit ndërkombëtare, e cila ka të bëjë me kemikaljet, Protokolli RLBN gjithashtu si “prindi” i saj – Konventa e Aarhusit, gjen origjinën e vet në Samitin Botëror të Planetit Tokë, të mbajtur në Rio në vitin 1992.

Gjatë Konferencës mbi Mjedisin Jetësor dhe Zhvillimin, të organizuar nga KB dhe mbajtur në Rio de Zhaneiro, është theksuar rëndësia e qasjes së publikut në informacionet mbi ndotjen e mjedisit jetësor, duke përfshirë këtu dhe regjistrat e emetimeve. Parimi 10 i Deklaratës së Rios mbi Mjedisin Jetësor dhe Zhvillimin tregon se “çdo individ do të ketë qasje përkatëse në informacione lidhur me mjedisin jetësor, të cilat janë në posedim të institucioneve publike”, si dhe “mundësia për të marrë pjesë në procesin e sjelljes së vendimeve” dhe se vendet “do ta nxisin vetëdijen publike dhe pjesëmarrjen, nëpërmjet të mundësimit të disponueshmërinë e gjerë të informacioneve”.

Kapitulli 19 i Agjendës 21 rekomandon që qeveritë të grumbullojnë informacione të mjaftueshme mbi mjedisin jetësor, duke mundësuar në të njëjtën kohë një qasje publike në ato.

Qeveritë, në bashkëpunim me industrinë dhe publikun, është paraparë që të përpilojnë një bazë të të dhënave për kemikaljet, duke përfshirë këtu dhe regjistrat e emetimeve. Neni 19 i Agjendës 21 gjithashtu urdhëron se baza e sigurisë nga kemikaljet është vetëdija më e gjerë e mundshme për rreziqet nga ato.

Për zbatimin e këtyre obligimeve që dalin nga Agjenda 21 në kuadër të Komisionit Ekonomik të Kombeve të Bashkuara për Evropën (UNECE), në vitin 1996 kanë filluar negociatat për miratimin e një Konvente e cila do të kishte përfshirë çështjet lidhur me qasjen në informacione, pjesëmarrjen e publikut në vendim-sjellje dhe qasjen në drejtësi për çështjet lidhur me mjedisin jetësor. Konventa është miratuar në vitin 1998 në qytetin danez Aarhus gjatë Konferencës së katërt Ministeriale në kuadër të procesit “Mjedisin jetësor për Evropën”. Sot, ajo njihet si Konventa e Aarhusit (KA²⁰).

Negociatat për Protokollin RLBN në bazë të KA kanë filluar në vitin 2001 dhe përfundojnë me miratimin e Protokollit në maj të vitit 2003 gjatë Konferencës së jashtëzakonshme Ministeriale, të mbajtur në Kiev.

Një çështje tjetër e rëndësishme për zhvillimin e regjistrave të ndotësve i cili ka dalur nga Konferenca mbi Mjedisin Jetësor dhe Zhvillimin e KB-ve, është ratifikimi i Protokollit për RLBN nga ana e Bashkimit Evropian në shkurt të vitit 2006.

Po të njëjtin muaj, Këshilli Evropian miratoi një rregullative për zbatimin e Protokollit në 27 vendet të atëhershme anëtare të BE-së. Marrëveshja plotësuese midis BE-së dhe Shoqërisë Evropiane për Tregti të Lirë (EFTA) zgjeron obligimin për raportim vjetor të RLBN-së mbi katër vende plotësuese (Zvicra, Norvegjia, Islanda dhe Lihtenshtajni).

[20] <http://www.unece.org/fileadmin/DAM/env/pp/documents/cep43e.pdf>

Protokolli RLBN është instrumenti i parë juridiko-detyrues ndërkombëtar për emetimet dhe transportin e materjeve ndotëse nga operatorët.

Deri në dhjetor të vitit 2014, dyzetë e një vend, si dhe BE-ja u bënë nënshkruese të Protokollit, ndërsa gjithsej tridhjetë e dy vende plus BE-ja kanë ratifikuar këtë instrument.

Protokolli hyri në fuqi më 8 tetor të vitit 2009, 90 ditë pasi Franca ratifikoi dokumenti, duke u bërë me këtë vendi i 16-të ratifikues, gjë kjo e cila do ta sigurojë hyrjen e instrumentit në të drejtën ndërkombëtare.

Përfshirja e E-RLBN

- E-RLBN përfshin 27 vende anëtare të BE-së, Islandën, Norvegjinë, Zvicrën dhe Serbinë.
- Regjistri grumbullon informacione nga më se 27000 instalime që i takojnë njërit nga 9 sektorët dhe kryejnë një apo më tepër nga 65 aktivitetet të numëruara në Aneksin 1 të Protokollit.



E-RLBN dhe Direktiva PKIN

PKIN-i evropian paraqet në një mënyrë, vazhdimin dhe avancimin e Direktivës PKIN në kuptimin e përcaktimit të aktiviteteve. Gjegjësisht, E-RLBN në masë të madhe ngërthen në vete të gjitha aktivitetet që janë përcaktuar paraprakisht me Aneksin 1 të Direktivës PKIN, por megjithatë, Protokolli përmban disa ndryshime dhe aktivitete plotësuese të cilat nuk janë përfshirë me Direktivën PKIN dhe janë pjesë të Aneksit 1 të Protokollit, dhe ato janë:

- 1 (e) Kodrina të thëngjillit me kapacitet nga 1 ton për orë;
- 1 (dh) Instalimet për prodhimin e produkteve të thëngjillit dhe karburant të fortë pa tym;
- 3 (a) Aktivitete nëntokësore xeherore dhe aktivitete të ngjashme;
- 3 (b) Nxjerrja sipërfaqësore e mineraleve dhe gurrit me sipërfaqe të një gjermimi efektiv të hapur 25 hektarësh;
- 5 (dh) Stacione pastrimi të ujërave të zeza urbane me kapacitet për 100.000 banorë;
- 5 (e) Stacione pavarësisht të administruara për ujëra të zeza industriale, të cilët shërbejnë për një apo më tepër aktivitete të numëruara në Aneksin 1 të Protokollit me kapacitet pastrimi nga 10.000 m³ për ditë;
- 6 (b) Bimët industriale për prodhimin e letrës, pllakave metalike dhe produkteve tjera primare të bëra nga druri (për shëmbull, nga kompensata, mediapani, shper-pllaka, e ngjashëm), me kapacitet prodhimi nga 20 tonë në ditë;
- 6 (c) Impiantet industriale për mbrojtjen e drurit dhe produkteve nga druri me kemikalje, me kapacitet prodhimi nga 50 m³ në ditë;
- 7 (b) Ruajtja intensive e peshkut dhe guaskave, me kapacitet prodhimi nga 1000 tonë në vit;
- 9 (d) Instalimet për ndërtim lyerje ose mënjanim të ngjyrës së anijeve, me kapacitet për anije me gjatësi nga 100 m.

Nëse operatorët ose organi përgjegjës për administrimin e RLBN-së kombëtare marrin hapa me të cilat vështirësohet implementimi i Protokollit, vendi mund të aplikojë të ashtuquajturat “masa përkatëse implementimi”. Megjithatë, Protokolli nuk definon këto masa në përgjithësi dhe ua lë autoriteteve që në kuadër të legjislacionit kombëtar t’i definojnë mënyrat e zbatimit të Protokollit në praktikë.

Për çfarë bëhen raportimet?

- Për lëshimet e cilësdo materje të numëruar në Shtojcën 2;
- Për bartjen e jashtme të cilësdo materje të numëruar në Shtojcën 2 nëpërmjet të ujërave të zeza, të cilat duhet të trajtohen/pastrohen jashtë instalimit;
- Për bartjen e jashtme të mbeturinave (shprehur në tonë në nivelin vjetor), të menduar për mënjanimin ose përpunimin/ripërdorimin;
- Për bartjen e jashtme të mbeturinave të rrezikshme, ku ka filluar bartja, si dhe për destinacionin e fundit të mbeturinave.



Konventa e Aarhusit dhe Protokollit RLBN

RLBN paraqet një vegël për qasjen e publikut në informacionet lidhur me mjedisin jetësor, lidhur me mjedisin jetësor nëpërmjet të inventareve të ndotjes që është shkaktuar nga industria ose nga burime tjera.

Konventa e Aarhusit (KA) kërkon nga vendet anëtare t'i ndjekin lëshimet dhe bartjen e materjeve ndotëse.

Konventa përfshin dispozita të gjera dhe fleksibile, të cilat obligojnë anëtarët të vendosin “inventarë ose regjistra të ndotësve” kombëtare dhe të disponueshme për publikun, të cilat përfshijnë hyrjen, lëshimet dhe bartjen e materjeve dhe produkteve ndotëse.

Në pajtim me Konventën, vendet duhet vepruar në mënyrë progresive dhe në themelimin e RLBN-së.

Protokollit RLBN rregullon themelimin e regjistrave, siç është paraparë me KA-në dhe më detajisht. Gjegjësisht, edhe pse Protokollit i RLBN-së dhe KA-ja janë të lidhura ngushtë në qasjet e tyre unike në inkuadrimin e publikut në sjelljen e vendimeve për mjedisin jetësor, por ato janë megjithatë, instrumente juridike vetanake dhe të pavarura.

Gjatë takimit të palëve të Protokollit, mbajtur nga 20 deri 22 prill të vitit 2010 në Gjenevë, u miratua një sërë masash të cilat përcaktuan institucionet dhe procedurat kryesore, detyra e të cilave është të sigurojnë zbatimin efektiv të Protokollit, përfshirë këtu dhe rregullat e punës, mekanizmin e harmonizimeve, sistemin e raportimit mbi zbatimin, skemën e kontratave financiare dhe plani i punës katërvjeçar.

Mekanizmi i harmonizimit ndjek të njëjtën qasje si atë të KA-së, duke mundësuar që cilido anëtar i publikut të kërkojë revizionimin e harmonizimit nga organi përkatës, me nënshtrimin e ankesës – parashtresës. Gjithashtu, në takim është formuar dhe një Grup Pune Ndërqeveritar dhe është zgjedhur një Byro, që synon mbikëqyrjen e funksionimit të programit të punës në kohën midis seancave të takimeve të palëve. Pala e Protokollit e cila nuk është palë e KA-së nuk përballet me kufizimet e realizimit të të drejtave të veta që dalin nga Protokollit. Aktivitetet që dalin nga Protokollit janë financuar posaçërisht nga aktivitetet që dalin nga programi i punës së Konventës së Aarhusit. Rregullat e punës të Protokollit dhe masat tjera administrative gjenden në pavarësi të plotë nga rregullat dhe procedurat e Konventës.

Regjistri i emetimeve dhe bartjes së ndotësve mundësojnë qasje në informacione mbi emetimet lidhur me lëshimin dhe bartjen e materjeve ndotëse jashtë burimit të ndotjes, mbeturinat dhe trendet e tyre për shumicën e industrive ndotëse. Si të tilla, ato mund t'u ndihmojnë vendimsjellësve gjatë përcaktimit të prioriteteve për aprovimin e strategjive për pakësim efektiv të emetimeve, si dhe për matjen e progresit në pakësimin e ndotjes. Regjistrat e tillë mund të ndihmojnë dhe vëzhgimin e progresit dhe përmbushjen e obligimeve ose marrëveshjeve të caktuara kombëtare, evropiane ose ndërkombëtare.

Me Rregullativën 166/2006²¹, Bashkimi Evropian themeloi Regjistrin Evropian të Lëshimeve dhe Bartjes së Ndotësve, duke synuar implementimin e Protokollit RLBN dhe të Konventës së Aarhusit.

Ai bazohet dhe avancohet Regjistrin Evropian të Emetimit të Ndotësve (EPER), i cili u themelua paraprakisht në vitin 2000.

Protokollit është i hapur për të gjitha vendet anëtare të KB-ve, duke përfshirë këtu dhe gjithë ato vende që nuk janë anëtare të UNECE-së ose palë të Konventës së Aarhusit.

Ndërkaq, Protokollit është i hapur për të gjitha organizatat për integrim ekonomik rajonal, të cilat mund të inkuadrohen dhe t'i realizojnë të drejtat e tyre në kuadër të Protokollit dhe këtë mund ta bëjnë në mënyrë kolektive ose në emër të anëtarëve të vet, nëse ata vendosin ashtu.

[21] <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/HTML/?uri=CELEX:32006R0166&from=EN>



Synimi kryesor i E-RIPZ²² është të sigurojë transparencë në administrimin e mjedisit jetësor nëpërmjet të vënies së obligimit për raportim mbi emetimet e ndotësve industrial. Obligimet për raportimin e emetimeve janë të lidhura me aktivitete industriale specifike sipas pragut paraprakisht të përcaktuar të ndotjes, e sidomos me aktivitetet që janë përfshirë me Direktivën 2008/1²³ për parandalim dhe kontroll të integruar të ndotjes.

Raportimi ka të bëjë me mundësimin e informacioneve mbi lëshimet nga ndotësit e numëruar të mjedisit jetësor si rezultat i aktiviteteve të tyre – nëse do të jenë ato të qëllimta, të rastësishme, rutinore ose jo (tek vet impianti dhe mbi pragu e përcaktuar)

Vlerat e raportuara duhet të jenë rezultat i matjeve të kryera, kalkulimeve ose vlerësimeve, në pajtim me metodologjitë ndërkombëtarisht të miratuara.

Si funksionon Protokollin?

Qëllimi i Protokollit RLBN është të garantojë qasje publike në informacione mbi lëshimet dhe bartjet e materjeve ndotëse, nëpërmjet të regjistrave kombëtarë të cilët mund të kërkohen në internet.

Instalimet janë të obliguar të raportojnë në nivel vjetor rreth lëshimeve në mjedisin jetësor dhe rreth bartjes së materjeve të caktuara ndotëse. Këto informacione regjistrohen në regjistrin publik, të njohur is RLBN.

RLBN paraqet një inventar të lëshimeve dhe bartjes së materjeve ndotëse nga instalimet industriale dhe nga burime tjera të ndotjes.

Këto sisteme përmbajnë informacione mbi materjet ndotëse nga emetime specifike industriale në ajër, dhé dhe ujë, e të cilat konsiderohen të jenë më të rrezikshme për shëndetin e njeriut dhe/ose për mjedisin jetësor.

RLBN gjithashtu përmban dhe informacione mbi mbeturinat toksike të cilat transportohen nga njëri instalim në tjetrin, në depo mbeturinash ose në një instalim për trajtimin e tyre.

RLBN mund të përmbajë dhe informacione mbi ndotjen nga burimet difuzive, si për shëmbull, mbi ndotjen e ajrit nga trafiku rrugor, ndotjen e ujit nga aktivitete bujqësore dhe/ose ndotjen e dheut, ajrit ose ujit nga kapacitetet e vogla ndotëse. Protokollin përkufizon burimet difuzive nëpërmjet të Nenit 2, paragrafit 9, si “shumica e burimeve më të vogla dhe të dispersuara të ndotjes, nga të cilët mund të lëshohen në dhé, ujë ose ajër, efekti i të cilave i kombinuar ose i përgjithshëm mund të jetë i konsiderueshëm dhe për të cilin nuk është praktike të grumbullohen raporte për secilin burim veçanërisht”.

Secila nga palët duhet siguruar kërkimin e informacioneve nga burime difuzive për secilën kategori të burimit difuziv, të definuar në regjistër. Inkuadrimi i burimeve difuzive gjendet në mesin e elementeve bazë të çdo RLBN.

Protokollin përmban raportim mbi burimet difuzive, pasi të dhënat mbi emetimet në shumë vende tregojnë se këto burime përbëjnë burimet më të rëndësishme të lëshimit të materjeve ndotëse kryesore.

Për shëmbull, inventari i UNECE-së i emetimeve për ndotje ndërkufitare të ajrit (LRTAP²⁴) tregoi se në territorin e Evropës, 25% CO₂, 55% NO_x, 58% CO dhe 27% NMVOC, origjinojnë nga trafiku rrugor.

Spektori bujqësor emeton 49% të metanit të përgjithshëm (CH₄) dhe 65% të dyoksidit azotik (N₂O). Për shëmbull, në Holandë, ku në këtë sektor veprues kryesor janë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, pothu-

[22] www.prtr.ec.europa.eu

[23] <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/HTML/?uri=CELEX:32008L0001&from=EN>

[24] http://www.unece.org/env/lrtap/status/lrtap_s.html

ajse të gjitha lëshimet e azotit, fosforit dhe metaleve të rënda në dhé i shkruhen bujqësisë dhe kështu, këto subjekte janë drejtpërsëdrejti përgjegjëse për lëshimin e fosforit (me 45%) dhe të azotit (me 65%) në ujërat sipërfaqësore.

— Neni 7, (paragrafi 7) —

Obligim për raportim ose aplikim të masave për
nisjen e raportimit mbi burimet difuzive

Secila palë, në regjistrin e vet, me shpërndarje të përshtatshme hapësinore do të prezantojë informacione mbi lëshimin e materjeve ndotëse nga burimet difuzive, për të cilat ajo palë ka përcaktuar se të dhënat janë grumbulluar nga organet relevante dhe mund të inkuadrohen në mënyrë praktike.

Kur pala ka përcaktuar se të dhëna të tilla nuk ekzistojnë, ajo është e obliguar të aplikojë masa me të cilat do të inicojë raportim mbi lëshimin e materjeve ndotëse relevante nga një apo më shumë burime difuzive, në pajtim me prioritetet e saja kombëtare.

Publiku mund ta kërkojë sistemin në internet për informacione specifike lidhur me kompanitë, materjet ndotëse, zonat gjeografike, etj. Regjistrat e tillë mundësojnë pjesëmarrje të publikut në sjelljen e vendimeve dhe kontribuojnë për parandalimin dhe pakësimin e ndotjes së mjedisit jetësor.

Sistemet RLBN janë dëshmuar të jenë vegla efektive për administrimin e mjedisit jetësor, të cilat ofrojnë përfitime për gjithë vepruesit shoqëror. Roli elementar i këtyre sistemeve është t'i lokalizojë mbeturinat kimike, ta ngrit vetëdijen ekologjike, t'i prioritetizojë burimet e kemikaljeve dhe të mundësojë inventare kombëtare për ato. Këto sisteme kanë më tepër funksione, si për shëmbull:

- Rregullisht të grumbullojnë informacione mbi materjet kryesore ndotëse, duke përfshirë këtu dhe zhivën;
- Të ulen shpenzimet e Qeverisë dhe shpenzimet e industrisë në bazë të një sistemi të raportimit;
- Të ruhen dhe procesohen informacionet të cilat do të mundësojnë ripërtëritjen – ndjekjen e lëshimeve;
- Të mundësojnë një portal për transmetimin e informacioneve për opinionin publik;
- Të mundësojnë informacione gjithëpërfshirëse për raportim dhe ndjekje të kemikaljeve të rrezikshme për identifikim të prioriteteve të administrimit të kemikaljeve në kuadër të planeve kombëtare të vepërimit;
- Të inkurajojnë nisma për procese prodhuese “më të pastra”.

Edhe pse Protokollin rregullon informacionet mbi ndotjen, dhe jo vetë ndotjen, pritet që ai të ndikojë mbi pakësimin e ndotjes, pasi kompanitë nuk dëshirojnë të identifikohen si ndotësit kryesor.

Përmbajtja e Protokollit të RLBN-së

Protokollin përbëhet nga preambula dhe 30 nene. Pjesë përbërëse e Protokollit janë dhe katër shtojcat të cilat mbulojnë fushat në vijim:

- Shtojca 1



Me këtë Shtojcë kategorizohen aktivitetet e instalimeve sipas sektorëve dhe përcaktohet pragu i raportimit në bazë të kapacitetit prodhues, gjegjësisht, sipas numrit të të punësuarve në instalim. Konform Protokollit, e në lidhje me përcaktimin e llojit të pragut, vendi palë i Protokollit vetë përcakton prapun e raportimit. Në pajtim me këtë Shtojcë, aktivitetet ndahen në dhjetë sektorë kryesorë, si vijon:

1. Sektori energjetik
2. Prodhimi dhe përpunimi i metaleve
3. Industria minerale
4. Industria kimike
5. Administrimi i mbeturinave dhe ujërave të zeza
6. Prodhimi dhe përpunimi i drurit dhe letrës
7. Blegtoia intensive dhe akuakultura
8. Prodhimet kafshore dhe të perimeve nga sektori i ushqimit dhe pijeve
9. Aktivitete tjera.

Këto nëntë sektorë kryesor në vazhdim po ndahen në disa nënsektorë dhe për secilin nga ata është përcaktuar pragu i raportimit (sipas kapacitetit të prodhimit dhe sipas numrit të personave të punësuar).

-Shtojca 2

Kjo Shtojcë jep një pasqyrë tabelare të listës së materjeve ndotëse të cilat janë lëndë e raporteve RLBN. Kjo tabelë ka të bëjë me gjithsej 91 materje ndotëse, ku secila materje ka numër vetanak CAS (Chemical Abstract Service)²⁵, prag të caktuar të lëshimit për çdo media veçanërisht (ujë, ajër ose dhé), prag të caktuar nëse bëhet bartja e materjes, gjegjësisht, prag të përcaktuar nëse materjet përdoren në prodhim ose në procesin e përpunimit të instalimit.

-Shtojca 3

Kjo Shtojcë përbëhet nga dy pjesë:

Pjesën A, e cila jep sqarim për aktivitetet që kanë të bëjnë me deponimin e materjeve ndotëse dhe plotësueshëm elaboron termin “deponim”, duke marrë parasysh gjithë metodat aktuale, pavarësisht se për cilën media ekologjike bëhet fjalë.

Pjesën B, e cila ka të bëjë me aktivitetet për ripërtëritje/riciklim dhe detajisht arsyeton dhe përkufizon domethënien e këtij aktiviteti në kuptimin e aplikueshmërisë së saj në kuadër të proceseve prodhuese.

-Shtojca 4

Në bazë të Nenit 23, paragrafit 2 të Protokollit, kjo Shtojcë detajisht elaboron procesin e arbitrazhit nëse shfaqet një kontest midis dy apo më shumë vendeve palë të Protokollit.

Teksti i integruar i Protokollit RLBN me katër shtojcat e veta është pjesë përbërëse e këtij studimi.

Materjet ndotëse të përfshira me RLBN

Sistemi RLBN ka të bëjë me informacione mbi emetimet e 91 materjeve ndotëse, përfshirë këtu dhe materjet të cilat shkaktojnë shijrat “acid”, gazrat e serrave, metalet e rënda, pesticidët e rrezikshëm dhe lartë toksik, kemikaljet të cilat shkaktojnë sëmundje të rënda tek njerëzit, e ngjashëm. Të gjitha këto materje, substanca, elemente janë numëruar në listën e Shtojcës 2 të Protokollit RLBN dhe në përmasë të

madhe kjo listë përputhet me listën e materjeve ngulmuese ndotëse organike (POPS)²⁶ të përcaktuar me Konventën e Stokholmit. Veç kësaj, regjistrat kombëtarë mundësojnë raportim mbi burimet difuzive të ndotjes, si për shembull, trafiku rrugor, bujqësia, etj.


Theksi i Protokollit vihet mbi sasinë e ndotjes, duke u orvatur për sigurimin e balancit midis relevancës së informacioneve të siguruar nga operatori dhe “barrën” mbi operatorin nga vetë raportimi. Gjegjësisht, në vend se të vendoset një listë me numër të madh të materjeve ndotëse individuale, Protokolli fokusohet në një numër të kufizuar të substancave dhe elementeve specifike, të ndara në disa kategori, duke synuar arritjen e një pasqyreje të qartë dhe gjithëpërfshirëse mbi volumin dhe sasinë e ndotjes. Gjithashtu, RLBN përfshin materjet dhe përzierjet më të rëndësishme ndotëse, siç janë PM10, karboni i përgjithshëm organik, përzierjet organike hallogjenetike, fenolet, dioksinet, cianidi, fluoridi, etj. Këto grupe të përzierjeve përbëjnë gjithë zonën e mbuluar me më se një mijë substanca të rrezikshme individuale.

Mes tjerash, Protokolli parashtron kërkesa minimale në lidhje me raportimet nga vendet, kështu që çdo vend ka lirinë që nëpërmjet të kornizës së përgjithshme të Protokollit, ta bëjë krijimin e RLBN-së në pajtim me objektivat dhe prioritetet kombëtare. Kështu, për shembull, nëse ndonjë impiant i caktuar emeton sasi të konsiderueshme të sasive të ndonjë substance të dëmshme e cila nuk është përfshirë me Protokollin RLBN (Shtojca 2), dhe është konstatuar nga institucionet kombëtare si e rrezikshme për shëndetin e njeriut dhe ambientin, atëherë vendi mund ta përfshijë atë substancë në regjistrim kombëtar të raportimit. Megjithatë, materjet ndotëse të përfshira me RLBN kufizohen, ndalohen ose largohen nga lista zyrtare, vetëm me ndihmën e marrëveshjeve ndërkombëtare, ndërsa ky mekanizëm është përcaktuar në kësi mënyrë me qëllim që të sigurojë një përfshirje kompetente ndërkombëtare në vetë procesin.

Lista nga Shtojca 2 përmban 91 materje ndotëse dhe varësisht nga përbërësve të tyre, ato janë grupuar në shtatë grupe kryesore të substancave ndotëse:

- Gazra të serrave
- Gazra tjera
- Metale të rënda
- Pesticide
- Substanca të kloruara organike
- Substancat joorganike

ЕС No. 166/2006 – АНЕКС II – ЗАГАДУВАЧКИ МАТЕРИИ



Bartja e materjeve ndotëse

Me termin “lëshim” nënkuptojmë emetim ose futje të materjeve ndotëse në mjedisin jetësor nga impianti ose nga ndonjë burim tjetër. Për dallim nga “lëshimi”, me nocionin “bartje” nënkuptohet lëvizja e materjeve ndotëse ose e mbeturinave, e menduar për mënjanim ose për ripërtëritje edhe të materjeve ndotëse në ujërat e zeza, të menduara për pastrimin jashtë kufijve të kapacitetit. Domethënë, me Protokollin përfshihen vetëm

[26] <http://chm.pops.int/TheConvention/ThePOPs/The12InitialPOPs/tabid/296/Default.aspx>



e vetëm raportimet mbi bartjen e jashtme. Lëvizja e materjeve ndotëse dhe/ose mbeturinave midis dy instalimeve që janë pjesë të një impianti, gjegjësisht, dy ose më tepër impiante që janë brënda kufijve të një vendndodhjeje të vetme, konsiderohet si bartje e brendshme dhe për këtë nuk duhet raportuar. Protokollu u mundëson palëve që vetë ta zgjedhin qasjen në raportimin mbi bartjen e jashtme. Gjegjësisht, në pajtim me RLBN, ekzistojnë dy qasje të raportimit:

- Raportimi mbi bartjen e materjeve ndotëse specifike;
- Raportimi mbi bartjen e mbeturinave specifike.

Në rastin e parë, organi kompetent e urdhëron impiantin që të raportojë kur tejkalohet pragu i sasive të substancave kimike në mbeturinat gjatë periudhës së raportimit (një vit).

Në rastin e dytë, organi kompetent kërkon nga impianti të raportojë vetëm kur do të tejkalohet pragu i sasisë së përgjithshme të mbeturinave gjatë periudhës së raportimit (një vit). Nëse pala e Protokollit RLBN përcaktohet për qasjen e dytë, atëherë pragu i raportimit është vënë në 2000 tonë të mbeturinave të parrezikshme, dhe 2 tonë të mbeturinave të rrezikshme.

Nëse bartja e mbeturinave bëhet drejt një vendi tjetër, atëherë bëhet fjalë për një rast ndërkufitar dhe është i obliguar ta informojë organin kombëtar kompetent për destinacionin e fundit se ku këto mbeturina do të ishin deponuar ose do të ishin lëndë e riciklimit dhe/ose ripërdorimit.

Kush raporton?

- Instalimet që kryejnë një ose më tepër se 65 aktivitetet e numëruara në Shtojcën 1 të Protokollit RLBN ose tejkalojnë pragjet e përcaktuara;
- Operatorët tek të cilët bartja e jashtme e mbeturinave tejkalon pragjet e përcaktuara;
- Instalimet emetimet e të cilave në ajër, dhë ose ujë tejkalojnë pragjet e përcaktuara, që janë numëruar në Shtojcën 2 të Protokollit RLBN.

Në pajtim me Nenin 5 të Rregullativës për E-RLBN, operatorët e impianteve të cilat kryejnë një apo më tepër nga veprimtaritë e numëruara në Shtojcën 1 të Protokollit, duke mos tejkalluar pragjet e përcaktuara, janë të obliguar të dërgojnë raporte vjetore lidhur me volumin dhe llojin e lëshimit, deri tek institucionet relevante kombëtare, duke dërguar informacione që bazohen mbi kalkulime, matje ose vlerësime. Në pajtim me Shtojcën 1, në procesin e raportimit janë përfshirë rafinieritë, termocentralet, industria kimike dhe xehetare, impiantet për djegien e mbeturinave, industria e përpunimit të drurit dhe letrës, stacionet e pastrimit, kompanitë që merren me bujqësi intensive dhe akuakulturë, impiantet për përpunimin e produkteve me origjinë kafshore dhe bimore, etj. – gjegjësisht, 65 aktivitete të grupuara në 9 sektorë.

Shtojca 1 përmban një tabelë e cila është ndarë në tre kolona dhe ofron informacionet në vijim:

- Kodin/numrin specifik për secilin aktivitet (kolona e parë);
- Përshkrimin e shkurtër të aktivitetit specifik (kolona e dytë);
- Informacionin mbi prapun e përcaktuar sipas kapacitetit (kolona e tretë).

Raportimi është i domosdoshëm kur pragjet sipas kapacitetit, pragjet e lëshimeve ose pragjet e bartjes së jashtme të mbeturinave ose ujërave të zeza për pastrim janë tejkaluar. Në rast kur ka barazim të emetimeve ose bartjes me pragun e përcaktuar, atëherë nuk ka nevojë që të raportohet. Në rast kur për ndonjë aktivitet të caktuar të Shtojcës 1 nuk është përcaktuar pragu sipas kapacitetit, atëherë raportimi është i detyrueshëm për të gjitha instalimet që kryejnë këtë veprimtari²⁷.


Nëse një operator kryen disa (nën)aktivitete që bëjnë pjesë të një aktiviteti kryesor të shënuar në Shtojcën 1, në të njëjtën vendndodhje dhe në kuadër të instalimit, në atë rast operatori duhet bërë përmbledhjen e kapaciteteve të të gjithë (nën)aktiviteteve dhe në bazë të totalit të bëjë krahasimin me pragun e përcaktuar në po të njëjtën Shtojcë - nëse totali tejkalon pragun e përcaktuar, në atë rast raportimi bëhet i detyrueshëm. Në rast kur operatori nuk mund të përcaktojë se cilin aktivitet po e kryen, atëherë ai është i obliguar t'i drejtohet institucionit kompetent i cili është përgjegjës për administrimin e RLBN-së.

Legjislacioni kombëtar i palës në Protokoll përkufizon obligimet e pushtetit administrativ në kuptimin e asaj se kush do ta administrojë, plotësojë dhe validizojë regjistrin kombëtar.

Në vendet ku tanimë janë vendosur sistemet e raportimit mbi emetimet, grumbullimi i informacioneve mbi regjistrat kombëtarë bazohet mbi njërën nga dy strukturat e zakonshme:

1. Raportim në bazë të lejes tanimë të lëshuar/të marrë të operatorit;
2. Raportim i detyrueshëm në bazë të monitorimit të brendshëm të kryer nga operatori.

Vendet e BE-së tanimë kanë vendosur regjistrat në bazë të dy strukturave dhe me qëllim të parandalohet raportimi i dyfishtë i industrisë, është bërë dhe lidhja e procedurës së raportimit të RLBN-së.



[27] http://ec.europa.eu/environment/industry/stationary/eper/pdf/en_prtr.pdf





Zbatimi i Protokollit RLBN në RM

Historia

Konventa e Aarhusit (KA) si një marrëveshje ndërkombëtare paraqet njërin nga instrumentet më të rëndësishme për mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve për një ambient të shëndetshëm dhe të pastër. KA është nënshkruar nga më se 40 vende dhe është ratifikuar nga 26 vende të Evropës, përderisa Republika e Maqedonisë ratifikoqi atë në vitin 1999 me Ligjin për Ratifikim (“Gazeta Zyrtare e RM-së” nr. 40/99). Protokollin e regjistrave të ndotësve dhe bartjes së materjeve ndotëse – RLBN i Konventës së Aarhusit për qasje në informacione, pjesëmarrje të opinionit publik në sjelljen e vendimeve dhe qasja në drejtësi në rastet lidhur me mjedisin jetësor, është miratuar gjatë seancës së jashtëzakonshme të vendeve-nënshkruese (përfshirë këtu dhe Bashkimin Evropian) të KA-së, në kuadër të Konferencës së pestë Ministeriale Pa-nevropiane “Mjedisi jetësor për Evropën”, e cila u mbajt më 21 maj të vitit 2003. Protokollin u nënshkrua nga 36 vende anëtare dhe nga Bashkimi Evropian. Përfundimisht me 7 janar të vitit 2014, 33 vende kanë ratifikuar²⁸ Protokollin. Pas nënshkrimit të tij nga ana e Bashkimit Evropian, Protokollin RLBN u avancua me të ashtuquajturin E-RLBN, gjegjësisht, RLBN evropian²⁹.

Harmonizimi i legjislacionit të brendshëm me kërkesat e Protokollit RLBN

Republika e Maqedonisë nënshkroi Protokollin në maj të vitit 2003. Në pajtim me obligimet që dalin nga Protokollin, vendi-nënshkrues është i obliguar të themelojë dhe të mirëmbajë një bazë të të dhënave të disponueshme publikisht në formë të regjistrit kombëtar të lëshimit dhe bartjes së materjeve ndotëse. Për këtë synim, Republika e Maqedonisë, gjegjësisht, Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, si organ i shtetit kompetent për të kryer veprimtari nga lëmi i mjedisit jetësor, filloi me zbatimin e një sërë aktiviteteve, për të plotësuar obligimet që dalin nga firmosja e Protokollit. Kështu, është bërë harmonizimi i legjislacionit të brendshëm me legjislacionin e BE-së³⁰, gjë kjo nga e cila dolën dokumentet në vijim:

1. Në kuadër të Projektit “Fuqizimi i Kapacitetit të Ministrisë së Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor” gjatë transponimit të legjislacionit evropian në Republikën e Maqedonisë, janë hartuar pako të ligjeve dhe akteve nënligjore mbi mjedisin jetësor. Ligji mbi Mjedisin Jetësor paraqet një ligj kornizë (sistematik) dhe bashkon gjithë katër ligjet tjera të posaçme: për cilësinë e ajrit, për administrimin e mbeturinave, për mbrojtjen natyrës, si dhe ligji mbi ujërat. Ai paraqet një hap i madh përpara në drejtim të krijimit të kushteve për zbatimin e dispozitave të Protokollit si një nga shtyllat e Konventës së Aarhusit, ndjek obligimet që janë përcaktuar me Protokollin e Konventës dhe përmban dispozitat të cilat do të mundësojnë realizimin cilësor të së drejtës së qasjes në informacione, të pjesëmarrjes së opinionit publik në sjelljen e vendimeve si dhe qasjes më të mirë në drejtësi lidhur me çështjet e mjedisit jetësor.

2. Në kuadër të po të njëjtit Projekt, janë hartuar dhe katër strategji, të cilat do ta lehtësojnë rrugën gjatë zbatimit të ligjeve. Janë pra këto në vijim: Strategjia për Monitorimin e Mjedisit Jetësor, Strategjia për Administrimin e të Dhënave, Strategjia për Komunikim në Mjedisin Jetësor dhe Strategjia për Ngritjen e

[28] <http://www.unece.org/env/pp/prtr.html>

[29] Rregullativa (EC) Nr. 166/2006

[30] Direktivat: 96/62/EC, 2008/50/EC, 2001/81/EC, 2000/80/EC, 96/61/EC, 2008/1/EC, 2000/60/EC, 91/271/EC, 2000/479/EC

Vetëdijes Publike mbi Mjedisin Jetësor.

3. Projekti “Mbështetja e zhvillimit të strategjive për implementimin e Konventës së Aarhusit” ndihmoi zhvillimin e një analize të hollësishme të cilësisë dhe sasisë së zbatimit të parimeve të Konventës në Republikën e Maqedonisë. Në bazë të vlerësimit të marrë nga analiza e lartëpërmendur dhe në përputhje me Programin Rajonal për Rikonstruimin e Mjedisit Jetësor në Evropën Juglindore (REReP) është hartuar dhe “Strategjia e Implementimit të Konventës së Aarhusit në Republikën e Maqedonisë” e cila rekomandon udhëzime në hartimin e Planit Kombëtar të Veprimit për aplikimin e Konventës së Aarhusit në praktikë, nëpërmjet të sigurimit të transparencës, pjesëmarrjes së palëve të interesuara dhe definimit të prioritetëve.

4. Ligji kornizë po fut në përdorim një Monitorim të Mjedisit Jetësor, sistem ky informativ për administrimin e të dhënave, si dhe një veprimtari hulumtuese dhe arsimim në lëmin e mjedisit jetësor.

5. Me qëllim implementimi i plotë dhe i suksesshëm i Protokollit RLBN, MMJPH zhvilloi një sistem informativ për mjedisin jetësor në kuadër të Projektit REReP 1.8 (Zhvillimi i sistemeve informative kombëtare mbi mjedisin jetësor në vendet e Evropës Juglindore). Megjithatë, për arsye të resurseve të kufizuara, vetëm një pjesë e sistemit është zhvilluar deri tani. Sistemi informativ po mirëmbahet dhe po organizohet në mënyrë që të sigurojë bazë të të dhënave relevante – informacione gjithëpërfshirëse, të sakta dhe të disponueshme në publik, lidhur me gjendjen e natyrës, gjendjen e cilësisë së mediave të mjedisit jetësor dhe lëmet tjera të mjedisit jetësor, pra, zhurma, rrezatimi jonizues ose jo-jonizues, përfshirë këtu dhe rrezatimin elektromagnetik dhe parasheh përdorimin e teknikave të modelimit.

6. Është vendosur një Kadastër i ndotësve të mjedisit jetësor (për: ajrin, ujin dhe mbeturinat), si pjesë e sistemit informativ, gjë kjo e cila është një aktivitet i vazhdueshëm, duke synuar grumbullimin e informacioneve mbi ndotjet në mjedisin jetësor, gjegjësisht mbi gjendjen në administrimin e mbeturinave, si dhe sasia dhe cilësia e materjeve ndotëse të emetuara në mediat e mjedisit jetësor, për arsye të ndjekjes së trendeve të treguesve të cilësisë së mediave të mjedisit jetësor, si dhe për shkak të kontrollit të suksesshmërisë së masave të aplikuara në bazë të vendimeve dhe zgjidhjeve përkatëse në nivelin lokal dhe atë shtetëror. Kadastri shfrytëzohet si bazë për zhvillimin e RLBN-në kombëtare.

7. Ligji për ratifikimin e Protokollit të regjistrave të emetimeve dhe bartjes së substancave ndotëse (“Gazeta Zyrtare e RM-së”, nr. 135/2010³¹).

8. Rregullorja për formën, përmbajtjen, metodologjinë dhe mënyrën e mbajtjes së Regjstrit të lëshimit dhe bartjes së ndotësve (“Gazeta Zyrtare e RM-së”, nr. 27/11).

9. Rregullorja për inventarizimin dhe përcaktimin e nivelit të emetimeve të substancave ndotëse me ajrin ambiental në tonë, në nivel vjetor për të gjitha llojet e veprimtarive, si dhe për të dhëna tjera të nevojshme për dërgim në programin e monitorimit të ajrit në Evropë (EMER) (“Gazeta Zyrtare e RM-së”, nr. 142/07³²).

[31] <http://www.slvesnik.com.mk/Issues/F0CD9E7304DAD749AC49BF7341250FE6.pdf>

[32] <http://www.slvesnik.com.mk/Issues/71553A2F41CAC0438333F5E84F997375.pdf>



10. Rregullorja për sasitë e kufijve të sipërme të emetimeve të substancave ndotëse, me qëllim përcaktimi i projekteve për një periudhë të caktuar kohore, të cilat kanë të bëjnë me pakësimin e sasive të emetimeve të substancave ndotëse në nivelin vjetor (“Gazeta Zyrtare e RM-së” nr. 2/2010³³).
11. Rregullorja për vlerat kufizuese për nivelet e lejuara të emetimeve dhe llojet e substancave ndotëse në gazrat dhe avujt e zeza, të cilat emetojnë burimet stacionare në ajër (“Gazeta Zyrtare e RM-së” nr. 141/2010³⁴).
12. Rregullorja për formën, metodologjinë dhe mënyrën e mbajtjes dhe azhurnimit të Kadastrit të ndotësve të ajrit (“Gazeta Zyrtare e RM-së” nr. 92/2010³⁵).
13. Rregullorja për formën dhe përmbajtjen e formulareve të dërgimit të të dhënave mbi emetimet në ajrin ambiant nga burime stacionare, mënyrën dhe afatin kohor për dërgim, në pajtim me kapacitetin e instalimit, përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së ditarit të emetimeve në ajrin ambiant (“Gazeta Zyrtare e RM-së” nr. 79/2011³⁶).
14. Lista e materjeve dhe substancave ndotëse (“Gazeta Zyrtare e RM-së” nr. 122/11³⁷).
15. Rregullorja për kushtet, mënyrën dhe vlerat kufizuese të emetimit për lëshimin e ujërave të zeza pas pastrimit të tyre, mënyrën e llogaritjes së tyre, duke patur parasysh kërkesat e posaçme për mbrojtjen e zonave të mbrojtura (“Gazeta Zyrtare e RM-së”, nr. 81/11³⁸).
16. Rregullorja për materjet dhe substancat e rrezikshme dhe të dëmshme dhe standardet e tyre të emetimit, të cilat mund të lëshohen në kanalizim ose në një sistem të ujitjes, në trupa ujore nëntokësore, si dhe në dhe bregdetare dhe në vendbanime ujore (“Gazeta Zyrtare e RM-së”, nr. 108/11³⁹).
17. Rregullorja për kushtet, mënyrën dhe vlerat kufizuese të emetimit për lëshimin e ujërave të zeza pas pastrimit të tyre, mënyrën e llogaritjes së tyre, duke marrë në konsideratë kërkesat e posaçme për mbrojtjen e zonave të mbrojtura (“Gazeta Zyrtare e RM-së” nr. 47/11⁴⁰).
18. Rregullorja për substancat për të cilat në mënyrë detyrimore përcaktohen vlera kufizuese të emetimit në lejen A të integruar ekologjike (“Gazeta Zyrtare e RM-së” nr. 72/10).
19. Rregullorja për substancat e rrezikshme, vlerat kufizuese (pragjet) e prezencës së substancave të rrezikshme dhe kriteret ose përbërësit sipas të cilëve substanca klasifikohet si e rrezikshme (“Gazeta Zyrtare e RM-së” nr. 25/10⁴¹).
20. Rregullorja për vlerat kufizuese të emetimeve gjatë ndezjes dhe djegies së mbeturinave dhe kushtet dhe mënyra e punës së instalimeve për ndezje dhe djegie (“Gazeta Zyrtare e RM-së” nr. 123/09⁴²).
21. Rregullorja për përbërjen dhe mënyrën e mbajtjes, ruajtjes dhe mirëmbajtjes së evidencës në Regjistrin e Mbeturinave (“Gazeta Zyrtare e RM-së” nr. 39/09⁴³).

[33] <http://www.slvesnik.com.mk/Issues/74D2694B503D2642858597B56A6C52CF.pdf>

[34] <http://www.slvesnik.com.mk/Issues/D43B492DE694BB4C8C8FC19A7D184479.pdf>

[35] <http://www.slvesnik.com.mk/Issues/FAD96E0ABEBD4E4BA78482B0413E03A4.pdf>

[36] <http://www.slvesnik.com.mk/Issues/48F45073541CA6448228187040613DC8.pdf>

[37] <http://www.slvesnik.com.mk/Issues/DEA9D9E4DA88EC4E93CB7E62B732214D.pdf>

[38] <http://www.slvesnik.com.mk/Issues/C7A5EBA121C1ED42BFE128BC26F7B163.pdf>

[39] <http://www.slvesnik.com.mk/Issues/5A43DE7E5D928644B2E94C12BB9C4223.pdf>

[40] <http://www.slvesnik.com.mk/Issues/69B525F06E82CB4A98C583CCE982CD98.pdf>

[41] <http://www.slvesnik.com.mk/Issues/AFF4F053C5A645409A29F05372E3A2A6.pdf>

[42] <http://www.slvesnik.com.mk/Issues/BB66E6BB6251C342805D534C3E5ECB78.pdf>

[43] <http://www.slvesnik.com.mk/Issues/DA59353547207049829D2B21D854B953.pdf>



Forma, metodologjia dhe mënyra e mbajtjes së regjistrit

Në pajtim me Nenin 41 të Ligjit mbi Mjedisin Jetësor (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 53/05 dhe ndryshimet 81/05, 24/07, 159/08, 83/09, 48/10 dhe 124/10), organi i administratës shtetërore kompetent për çështjet në lëmin e mjedisit jetësor themelon dhe mirëmbanë një Regjistër për lëshimin dhe bartjen e ndotësve (më tej referuar si: Regjistri i ndotësve) i cili është pjesë përbërëse i Kadastrit të Mjedisit Jetësor.

Duke marrë parasysh dispozitat e Protokollit, e në bazë të Nenit 41, paragrafit 2 të Ligjit mbi Mjedisin Jetësor (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 53/05 dhe ndryshimet 81/05, 24/07, 159/08, 83/09, 48/10 dhe 124/10), Ministri i Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor solli Rregulloren për formën, përmbajtjen, metodologjinë dhe mënyrën e mbajtjes së Regjistrit të lëshimit dhe bartjes së ndotësve (“Gazeta Zyrtare e RM-së” nr. 27/11⁴⁴) dhe ajo hyri në fuqi më 1 janar të vitit 2013. Qëllimi i sjelljes së Rregullorës ishte të vendoset një Regjistër RLBN kombëtar, i cili do të jetë në pajtim me kërkesat dhe obligimet ndërkombëtare dhe i cili do të lidhet ngushtë me objektivat e Konventës së Aarhusit.

Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor e RM-së, si organ kompetent për RLBN-në kombëtare, në bazë të Nenit 7, paragrafit 4 të Rregullores, po kujdeset për tërësinë dhe besueshmërinë e të dhënave që janë përfshirë në Regjistrin e ndotësve, si dhe për kontrollin e cilësisë dhe sigurimit të cilësisë së të dhënave në Regjistër, në kuptimin e kompetencës së tyre, konzistencës së tyre dhe besueshmërisë së tyre. Kompetenca do të thotë se të gjitha informacionet që kanë të bëjnë me identifikimin e impiantit dhe aktivitetet e tij të përcaktuara nëpërmjet të Shtojcës 1, janë plotësisht të përndjekura.

Konzistenca do të thotë se informacionet që duhet t’i dërgohen organit kompetent duhet të përcaktohen nëpërmjet të definicioneve uniforme dhe jo të dykuptimta, nëpërmjet të metodologjive të besueshme për identifikimin e burimeve dhe përcaktimin e lëshimeve për disa vite konsekuente. Raportimi konzistent i impianteve do t’i mundësojë Republikës së Maqedonisë një mënyrë raportimi relevante dhe konzistente në Komisionin Evropian dhe Agjencinë Evropiane për Mjedisin Jetësor.

Besueshmëria do të thotë se informacionet e dërguara nga operatorët duhet të jenë autentike, të sigurata, krahasuese dhe transparente.

Forma dhe përmbajtja e Regjistrit

Forma e Regjistrit kombëtar bazohet në dispozitat e numëruara në Nenin 5 të Rregullorës për formën, përmbajtjen, metodologjinë dhe mënyrën e mbajtjes së Regjistrit të lëshimit dhe bartjes së ndotësve. Gjegjësisht, RLBN-ja kombëtare mundëson që të dhënat dhe informacionet e marra nga operatorët të ruhen në një bazë të të dhënave të integruar sipas relacionit, me të dhëna mbi lëshimit dhe bartjes së ndotësve. Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor përpiloi një aplikim të programuar elektronik (softuer) me të cilin mundësohet një futje të rrjetshme, përpunim dhe pasqyrim të të dhënave të Regjistrit, mundësi për kërkim dhe qasje në të nëpërmjet të internetit me përdorim të emrit të përdoruesit dhe fjalëkalim dhe me mundësi për ruajtjen e të dhënave për një periudhë mbi 10-vjeçare. Qasshmëria e këtij softueri është siguruar nëpërmjet të internetit, gjegjësisht, nëpërmjet të web faqes:

[44] <http://www.slvesnik.com.mk/Issues/5333958A094BC74FAEA8F8DBCBE13331.pdf>

www.prtr.moepp.gov.mk dhe ofron një qasje dyshkallëshe në të. Domethënë, web faqja ofron qasje për opinionin publik në informacionet e përmbledhura nga softueri nëpërmjet të pasqyrimit kartografik të vendndodhjeve të instalimeve, duke mundësuar kështu qasje në raportet e dërguar nga operatorët. Qasja e dytë ka të bëjë me operatorët të cilët nëpërmjet të këtij softueri kanë mundësi që në mënyrë elektronike të regjistrohen dhe të fusin të dhëna mbi sasitë e emetimeve ose bartjes së materjeve ndotëse të gjeneruara në kuadër të proceseve prodhuese, në formë të raporteve.

Regjistri kombëtar përmban informacione për të gjithë instalimet e regjistruara dhe impiantet në to, duke përfshirë këtu dhe të dhëna mbi vendndodhjeve të tyre gjeografike, si dhe në zonën e pellgut lumor, ku ato përkasin. Veç kësaj, RLBN-ja kombëtare ofron informacione për veprimtaritë e instalimeve të regjistruara, lëshimit të materjeve ndotëse në ajër, ujë ose dhé, përderisa varësisht nga aktiviteti, mund të sigurojë informacione për krijimin dhe bartjen e mbeturinave jashtë pozicioneve të destinacionit të fundit, gjegjësisht, të sigurojë informacione mbi bartjen e ujërave të zeza jashtë pozicioneve.

Në lidhje me definimin e obligimeve për raportim, ato janë rregulluar me këtë Rregullore dhe janë elaboruar në detaje nëpërmjet të të dy grupeve të cilat ato përfshijnë:

1. Veprimtaritë nëpërmjet të të cilave kryhet krijimi, lëshimi dhe/ose bartja e materjeve ndotëse. Në pajtim me Shtojcën 1 të Rregullores, veprimtaritë janë ndarë dhjetë sektorë kryesorë, të cilët më tej ndahen në disa nënsektorë. Për secilin nënsektor është përcaktuar një prag i kapacitetit. Kjo do të thotë se instalimi ka për obligim të raportojë mbi emetimet ose bartjen vetëm nëse ka tejkaluar pragu e përcaktuar.

2. Materjet ndotëse të cilat lëshohen në ajër, dhé ose ujë dhe/ose transmetohen jashtë vendndodhjes së krijimit të tyre, gjegjësisht, bartja e ujërave të zeza e derin në destinacionin e fundit. Lista e materjeve ndotëse është shënuar në Shtojcën 2 të Rregullores dhe përmban gjithsej 91 materje, secila me kodin e vet dhe numrin e vet CAS (Chemical Abstract System). Veç kësaj, për çdo materje është përcaktuar pragu i lëshimit, varësisht nga ajo se në cilën media lëshohet (ajër, ujë ose dhé) dhe instalimet raportojnë vetëm në raste kur do të tejkalohet pragu i përcaktuar për çdo materje ndotëse veçanërisht.

— Neni 5 —

Regjistri i ndotësve përmban informacione për:

- instalimin, me të gjitha impiantet në të dhe vendndodhjen e tij gjeografike, përfshirë këtu dhe basenin lumor në të cilin gjendet;
- operatorin e instalimit përgjegjës për dërgim të informacioneve;
- veprimtaritë e instalimit;
- lëshimin e ndotësve në mediat e mjedisit jetësor (ajër, ujë dhe dhé);
- krijimin dhe bartjen e mbeturinave jashtë vendndodhjes dhe destinacioni i tyre, ashtu siç është e përshtatshme; dhe
- bartja e ujërave të zeza jashtë vendndodhjes.

Deri në dhjetor të vitit 2014, në sistemin kombëtar RLBN janë regjistruar gjithsej 11 kapacitete industriale, siç vijon: tre nga sektori energjetik, katër nga industria e minareleve, dy nga sektori i prodhimit të metaleve dhe një nga sektori i administrimit të ujërave të zeza. Megjithatë, në periudhën vijuese nevojitet bërja e regjistrimit të pothuajse gjithë instalimeve “A”, të cilat operojnë në territorin e Republikës së Maqedonisë. Në këtë mënyrë do të sigurohet një pasqyrë reale për burimet dhe



shkallën e ndotjes në RM, si dhe do të përmbushen obligimet e raportimit mbi ndotjen drejt opinionit publik të brendshëm dhe BE-së.

Mbajtja e regjistrit dhe identifikimi i impianteve RLBN

Si në vendet tjera, ashtu dhe në Republikën e Maqedonisë, strukturë relevante për themelimin dhe mirëmbajtjen e Regjistrit është Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, e cila, si organ i administratës shtetërore, është kompetente për grumbullimin, verifikimin dhe validizimin, besueshmërinë dhe ndarjen e të dhënave që janë përmbajtur në regjistër, si dhe plotësimin e obligimeve për raportim si ndaj opinionit publik të brendshëm, ashtu dhe ndaj organizatave ndërkombëtare.

Duke ditur faktin se Republika e Maqedonisë, me firmosjen e Marrëveshjes për Stabilizim dhe Asocim me Bashkimin Evropian, të gjitha angazhimet orientoi drejt harmonizimit të legjislacionit dhe standardeve të brendshme me ato të BE-së, Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor po e ndjek *acquis* ekologjik evropian dhe po orvatet për implementimin e tij të plotë në nivelin kombëtar.

Ndërkaq, rregullativa E-RLBN në përmasa të mëdha është integruar në legjislacionin kombëtar me qëllim përmbushja e kërkesave për raportim ndaj Komisionit Evropian dhe Agjencisë Evropiane për Mjedis Jetësor.

Identifikimi i impianteve RLBN bëhet në bazë të rregullativës E-RLBN, e cila udhëzon për vendosjen e numerimit identifikues të impianteve në çdo vend anëtar të Protokollit dhe i cili është pjesë e Bashkimit Evropian.

Veç kësaj, janë të domosdoshme informacionet për: emrin e kompanisë amë, emrin e impiantit, numrin e identifikimit, adresën e impiantit me kodin e tij postal, koordinatat, zonën e pellgut lumor dhe aktivitetin kryesor ekonomik, operatori i impiantit mund gjithashtu të jep informacione plotësuese të cilat nuk janë obligative, por mund të i shërbejnë publikut dhe organit kompetent në vlerësimin e cilësisë së të dhënave.

Në këtë drejtim, si informacione plotësuese mund të shtohen: volumi i prodhimit, numri i instalimeve, numri i orëve të punës në nivel vjetor, numri i të punësuarve, e ngjashëm.

Numerimi identifikues i impianteve bëhet me qëllim sigurimi i raportimit konzistent dhe mundësimi i vlerësimit të emetimeve dhe bartjes së materjeve ndotëse. Për të mundësuar këtë, nevojitet që numri identifikues i ndarë për secilin impiant veçanërisht, dhe ky numër duhet të mbetet i pandryshuar për një afat më të gjatë kohor.

Megjithatë, duke ditur mundësinë e ndryshimeve të strukturës së impiantit, siç është mbyllja, shpërngulja në një vend tjetër, shkrirja me impiante tjera e ngjashëm, vihet në pyetje “vazhdimësia” e numrit identifikues.

Nëse paraqiten ndryshime të këtilla në impiant, operatori duhet informuar organin kompetent për këtë, i cili, nëse e kërkon nevoja, do të ndajë një numër të ri për identifikim. Organi kompetent është



i obliguar të mbajë evidencë për të gjitha ndryshimet e numrave identifikues dhe për ato do t'i informojë institucionet ndërkombëtare kompetente.

Marrë në përgjithësi, rekomandimet në vijim aplikohen në lidhje me cilindo ndryshim të numrit identifikues të impiantit:

- Numrat e identifikimit nuk duhet të ndryshohen, përveç nëse nuk ekziston ndonjë nevojë jashtëzakonisht të rëndësishme për ta bërë këtë;
- Në rast të mbylljes së impiantit, numri i identifikimit duhet të ruhet të paktën 10 vite pasi të dhënat do të jenë të disponueshme në internet gjatë kësaj periudhe;
- Në rast të shpërnguljes së impiantit, ai duhet të merr një numër të ri identifikimi;
- Nëse impianti ndryshon emrin e operatorit ose kompaninë amë, numri i identifikimit duhet mbetur i njëjti;
- Nëse impianti shkrihet me një impiant tjetër në po të njëjtën vendndodhje, duke patur veprimtaritë e dy impianteve identike, në atë rast numri i identifikimit mbetet i njëjtë;
- Nëse impianti shpërbëhet, numri i identifikimit mbetet në impiantin i cili do ta vazhdojë veprimtarinë e regjistruar primare;
- Gjatë plotësimit të raportit vjetor, impianti duhet numëruar ndryshimet (nëse janë paraqitur) gjatë 10 viteve të fundit.

Obligimet dhe cikli i raportimit

Në pajtim me Nenin 8 të Rregullores, Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor e RM-së, për nevojat e Regjistrimit të ndotësve, një herë në vit, nga kadastrat e mjedisit jetësor, grumbullon të dhënat dhe informacionet nga operatorët e secilit instalim që kryen një apo më tepër veprimtari të përcaktuara me Shtojcën 1 të Rregullores.

Kjo do të thotë se operatori i secilit instalim i cili kryen një apo më tepër nga veprimtaritë e përcaktuara me Shtojcën 1 të Rregullores, deri në muajin mars të vitit aktual, deri tek organi kompetent dërgon në formë elektronike dhe të shkruar të dhënat dhe informacionet në vijim për vitin paraprak:

- lëshimi në ajër, ujë dhe dhé të cilitdo ndotës të përcaktuar me Rregulloren, për të cilin është tejkaluar pragu i përcaktuar në të;
- krijimi dhe bartja jashtë vendit të krijimit të mbeturinave të rrezikshme/ose të parrezikshe, për riciklim dhe deponim, me përjashtim të deponimit me pastrimin e dheut dhe injektimin e thellë, të shënuar në Ligjin mbi Administrimin e Mbeturinave, duke i shënuar ato me “R” ose “D” përkatësisht, dhe varësisht nga ajo nëse mbeturinat janë menduar për riciklim apo deponim, ndërsa për lëvizjet ndërkufitare të mbeturinave të rrezikshme – emrin dhe adresën e operatorit i cili kryen riciklimin ose deponimin e mbeturinave, ose vendin ku do të bëhet riciklimi ose deponimi;
- krijimi i lëshimit të ndotësve në ujërat e zeza të menduar për përpunim të mëtejshëm, prodhim dhe/ose bartje jashtë vendit të krijimit, për të cilin është tejkaluar pragu i përcaktuar me Rregullore.

Këto të dhëna dhe informacione dërgohen nga operatorët së bashku, me shënim nëse janë të dhë-

na dhe informacione të siguruara me matje, llogaritje ose vlerësim, duke shënuar detyrueshëm metodën analitike dhe/ose metodën e llogaritjes. Operatorët, shënimet me të dhënat në bazë të të cilave janë nxjerrë të dhënat dhe informacionet që kanë dërguar tek organi kompetent, duket t'i ruajnë për një periudhë pesë-vjeçare nga dita e dërgimit të tyre.

Metodat për përcaktimin e lëshimit

Një numër i madh kapacitetsh tanimë po grumbullojnë të dhëna që janë përkatëse për përcaktimin e lëshimeve dhe bartjes në ajër, ujë dhe dhé. Të dhënat mbi lëshimin dhe bartjen e substancave ndotëse nga çdo kapacitet për të cilin raportohet, mund të bazohen mbi tre metoda bazë të ndryshme për përcaktim:

- (a) Matjet (M), të cilat përdorin metoda të standardizuara ose të pranuara; Shpesh, nevojiten llogaritje plotësuese për të shndërruar rezultatet e matjes në të dhëna vjetore mbi emetimet;
- (b) Llogaritjet (C), me përdorimin e metodave kombëtare ose ndërkombëtarisht të pranuara për vlerësimin e faktorëve të emetimit, të cilat janë reprezentative për sektorët industrial;
- (c) Vlerësimet (E) (të pastandardizuara), të cilat dalin nga supozimet më të mira ose mendimet eksperte.

Matjet dalin nga monitorimi i drejtpërdrejtë i lëshimit dhe bartjes së materjeve ndotëse për procese të caktuara në kapacitetet, të cilat bazohen mbi matje faktike të koncentrimeve ose grimcave për çdo media.

Kur bie fjala për përcaktimin e lëshimit në bazë të llogaritjeve dhe matjeve, është e vlefshme për ta shënuar se në praktikën ndërkombëtare janë miratuar metoda specifike, të cilat bazohen në normative të ndryshme ndërkombëtarisht të pranuara. Kjo i përket dhe Republikës së Maqedonisë, ku softueri RLBN mundëson përdorimin e metodave të integruara për llogaritje dhe vlerësim të emetimeve.

Kodi i metodës	Përshkrimi i metodës	C – llogaritje; E – vlerësim; M – matje
C_EMEP	Llogaritja me përdorimin e udhëzimit UNECE/EMEP për invertizim të lëshimeve.	
C_ETS	Llogaritja me përdorimin e udhëzimit për monitorim dhe raportim mbi lëshimin e gazrave të serrave nëpërmjet të Skemës për Tregtinë e Lëshimeve (Emission Trading Scheme).	
C_IPCC	Llogaritja me përdorimin e udhëzimit PKIN.	
C_ISO	Llogaritja në përputhje me standardet ISO.	
C_MAB	Llogaritja sipas metodës së balancit të masës, e miratuar nga organi kompetent.	
C_NRB	Metodologjia e llogaritjes kombëtare ose rajonale detyrimore për operatorin, e përcaktuar me një akt juridik.	

Kodi i metodës	Përshkrimi i metodës	C – llogaritje; E – vlerësim; M – matje
C_OTH	Metodologji tjetër e llogaritjes.	
C_PER	Metodologjia e llogaritjes e cila tanimë është vendosur nga organi kompetent nëpërmjet të licencës së lëshuar ose lejes së integruar.	
C_SSC	Metoda specifike e llogaritjes, e ashtuquajtur “European-wide sector”.	
E	Vlerësim.	
M_ALT	Metodologjia alternative e matjes, në përputhje me standardet ekzistuese CEN/ISO.	
M_CRM	Metodologjia e matjes së përmbushjeve të demonstruara me materiale të certifikuar referente, dhe të pranuar nga organi kompetent.	
M_ISO	Standardi ndërkombëtarisht i pranuar CEN ose ISO për matje.	
M_NRB	Metodologjia kombëtare ose rajonale e matjes, e përcaktuar me një akt juridik.	
M_OTH	Një metodologji tjetër e matjes.	
M_PER	Metodologjia e matjes e cila tanimë është përcaktuar nga organi kompetent në formë të licencës ose lejes së integruar.	
M_SSC	Metoda specifike e matjes, e ashtuquajtura “European-wide sector”.	
M_WEIGH	Matja e peshës.	
U	E paspecifikuar.	

Cilësia e të dhënave

Sa i përket cilësisë së të dhënave të raportuara nga pronarët ose operatorët e kapaciteteve të cilët i nënshtrohen detyrimeve për raportim, ata janë të obliguar ta sigurojnë cilësinë e informacioneve të cilat i paraqesin dhe t'i shfrytëzojnë “informacionet më të mira të disponueshme”. Informacionet më të mira të disponueshme mund të inkuadrojnë të dhëna të monitorimit, faktorë emetimi, ekuacione të bilancit të masës, monitorim të drejtpërdrejtë dhe llogaritje tjera, si konkluzione inxhinierike, si dhe metoda tjera. Sistemi kombëtar RLBK merr në konsideratë cilësinë e të dhënave të futura nga operatori, duke mundësuar një krahasim midis informacioneve të kërkuara dhe të futura. Në një rast të këtillë, personi i autorizuar, i emëruar nga operatori orientohet në një drejtim të duhur kur bëhet fjalë për futjen e duhur të të dhënave RLBK në sistemin kombëtar. Qasja e këtillë në masë të madhe ndikon mbi efikasitetin e administratës publike, përgjegjëse për administrimin e sistemit RLBK dhe nga ana tjetër, konsiderueshëm lehtëson procedurën e raportimit.



Prezantimi i të dhënave

Baza RLBN mundëson një pasqyrë të përmbledhur të të dhënave kombëtare për të gjithë lëshimet dhe bartjes së materjeve ndotëse për të cilat bëhet raportimi. Prezantimi i këtyre të dhënave duhet qenë në formë të përmbledhura dhe jo të përmbledhura në dy dimensione, si vijon:

- Materjet ndotëse
- Aktivitetet

Raportet me të dhënat e përmbledhura kombëtare mund të shfrytëzohen dhe për dokumente tjera kombëtare (si për shembull, leje PKIN, e ngjashëm), gjë kjo me të cilën do t'i shmangemi dyfishimit të punës. RLBN prezanton informacionet për lëshimin dhe bartjen e materjeve ndotëse nga burimet e pikëzuara dhe difuzive, në një shpërndarje përkatëse hapësinore, duke përdorur një sistem informativ gjeografik (SIGJ). SIGJ paraqet një vegël të fuqishme, e cila jep pasqyrën e shtresave të informacioneve, me një qasje gjeografike. Kjo nënkupton se lëshimi dhe bartja e materjeve ndotëse nga kapacitete të cilat biejnë nën Shtojcën I të Protokollit, së bashku me koordinatat gjeografike, prezantohen në harta. Duke ditur se objektivi elementar i Protokollit RLBN është përmirësimi i qasjes së publikut në informacione, këto regjistra janë të disponueshme për publikun. Në Republikën e Maqedonisë, me realizimin e Projektit “Fuqizimi i kapaciteteve administrative për implementimin e Konventës së Aarhusit dhe veprimet për mbështetjen e zhvillimit të sistemeve RLBN në vendet e zgjedhura të Evropës Juglindore”, të implementuar nga Qendra Rajonale Ekologjike, në vitin 2013 është vendosur një vegël elektronike falas (softuer) e cila është donacion nga Agjencia Gjermane për Mjedis Jetësor.

Softueri, përveç që iu përgjigjet nevojave për raportim të Protokollit RLBN, ai gjithashtu ka mundësi të përshtatet në pajtim me nevojat dhe si vegël për përmbushjen e obligimeve tjera ndaj BE-së, siç janë raportimi për E-RLBN dhe LCP-në.

Funksionet kryesore të softuerit janë: procedura e raportimit të brendshëm midis operatorëve dhe institucioneve kompetente, përfshirë këtu dhe regjistrimin online, si dhe cilësia dhe kontrolli i të dhënave, gjenerimin e raportit, ndërsa funksioni tjetër i rëndësishëm lidhet me mundësinë e cila i jepet shfrytëzuesit për qasje në publik, si dhe palët tjera të interesuara të ndryshme, nëpërmjet të formateve të bazuara në ueb.

Veç kësaj, në kuadër të këtij Projekti është përkthyer Udhëzimi për zbatimin e Protokollit mbi regjistrat e ndotësve dhe bartja e materjeve ndotëse, i cili është lëshuar nga Sekretariati i UNECE-së i Konventës së Aarhusit. Qëllimi i këtij Udhëzimi⁴⁵ është të ndihmojnë palët e interesuara në implementimin e Protokollit në praktikë.

Dispozitat ndëshkuese të parapara me Ligjin mbi Mjedisin Jetësor të Republikës së Maqedonisë

Vëzhgimin e aplikimit të dispozitave ligjore dhe rregullave të sjella në bazë të Ligjit për Mjedisin Jetësor kryen administrata shtetërore, kompetente për punët në lëmin e mjedisit jetësor, gjegjësisht, Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor e Republikës së Maqedonisë. Duke ditur faktin se dispozitat që dalin nga Protokolli janë mishëruar në një obligim ligjor nëpërmjet të Rregullores për formën, përmbajtjen, metodologjinë dhe mënyrën e mbajtjes së Regjistrit të lëshimit dhe bartjes së ndotësve, në rast të mosrespektimit të tij, janë paraparë dispozita të përshtatshme ndëshkuese.

Vëzhgimin inspektues i aplikimit të Ligjit mbi Mjedisin Jetësor dhe rregullat të sjella në bazë të këtij Ligji kryen Inspektorati Shtetëror i Mjedisit Jetësor, nëpërmjet të inspektorëve shtetëror për mjedisin jetësor dhe inspektorëve shtetëror për mbrojtjen e natyrës (më tej në tekst referuar si: inspektorët shtetëror). Konform Nenin 198 të Ligjit mbi Mjedisin Jetësor, inspektori shtetëror, në kuadër të fushëveprimit të tij, është i autorizuar të përcaktojë nëse nga instalimi po prodhohen dhe lëshohen materje dhe substanca ndotëse në mjedisin jetësor, nëse instalimi tejkalon normat e përcaktuara dhe nëse nuk vepron me ato sipas mënyrës së përcaktuar. Mes tjerash, inspektori përcakton nëse bëhet import, eksport dhe tranzit në/nga/nëpër Republikën e Maqedonisë të substancave të rrezikshme dhe të materjeve dhe produkteve të dëmshme. Në po të njëjtën bazë, përcakton nëse bëhet monitorimi i burimeve të emetimit me të cilët ndotët një apo disa nga mediat e mjedisit jetësor; përcakton nëse përpiluesit i janë dërguar të dhënat e nevojshme për përpilimin dhe mbajtjen e Regjistrit të materjeve dhe substancave ndotëse, dhe veçoritë e tyre; përcakton nëse emetimet e substancave të definuara në leje lëshohen në pajtim me vlerat e përcaktuara kufizuese; përcakton nëse personat juridik dhe fizik dërgojnë të dhëna dhe informacione mbi mjedisin jetësor; përcakton nëse ruhen të dhënat për përdorimin e pasurive natyrore, lëndëve të para dhe energjisë, si dhe për emetimet e materjeve dhe substancave ndotëse, llojet, veçoritë dhe sasi të mbeturinave, e ngjashëm.

Veç kësaj, në kryerjen e vëzhgimit përbrënda fushëveprimit të tij, inspektori shtetëror kryen vëzhgimin në të gjitha instalimet, sistemet, impiantet dhe objektet për të cilat ekzistojnë njohuri se nga ato lëshohen dhe/ose rrjedhim emetime në mjedisin jetësor, dhe për të cilat ekziston dyshimi i bazuar se me lëshimet dhe/ose rrjedhjet mund të shfaqet ndotja e mjedisit jetësor ose rrezikimi i shëndetit të njerëzve.

Në kuadër të obligimeve të përcaktuara me ligj të inspektorit shtetëror, ai mund të sjell masa për mënjanimin e arsyeve të shfaqjes së dëmeve mbi mjedisin jetësor. Gjegjësisht, konform Nenit 200 të Ligjit mbi Mjedisin Jetësor, inspektori shtetëror mund të urdhërojë mënjanimin e pasojave të dëmshme për mjedisin jetësor, të përcaktojë masa për parandalimin dhe mënjanimin e ndotjes, të ndalojë ndërtim, rikonstruim ose punë në objektet, impiantet ose instalimet të cilat shkaktojnë ndotjen. Pastaj, inspektori shtetëror mund të konfiskojë pajisjen dhe aparatet që paraqesin burime të ndotjes, të urdhërojë marrjen e lejes së integruar ekologjike, si dhe t'i obligojë personat juridik dhe fizik për zbatimin e monitorimit të ndotjes, si dhe një sërë masash tjera që janë përmbledhur në Nenin e lartpërmendur.

Gjithashtu, ingerencat e veta në zbatimin e dispozitave të Ligjit mbi Mjedisin Jetësor, në pjesën e ndotjes në nivelin komunal, gjegjësisht, në nivelin e Qytetit të Shkupit, kanë inspektorë të autorizuar të cilët kryejnë vëzhgimin e ndotjes së shkaktuar nga objektet e impianteve dhe instalimeve



që janë përfshirë me lejet e integruara B. Edhe krahas asaj që puna e inspektorëve të autorizuar është kufizuar në ndotësit e përfshirë me lejet e integruara B, prapseprap ata mund dhe duhet luajtur rolin kryesor në evidentimin e rreziqeve të mundshme dhe kërcënimeve nga ndotja në nivelin lokal, duke realizuar një bashkëpunim intensiv me inspektorët shtetëror për mjedisin jetësor.

Në rast të shkeljes së dispozitave të Ligjit mbi Mjedisin Jetësor, objektet, impiantet dhe instalimet u nënshirohen tre kategorive të gjobave financiare kundërvajtëse të cilat shtrihen në vlerë nga 3000 deri 100 000 euro, varësisht nga shkalla e cenimit të dispozitave të Ligjit. Kështu, për shembull, kur objektet, impiantet dhe instalimet nuk dërgojnë informacione deri tek përpiluesi i regjistrit, ndjekin dënimin nga 3000 euro, ndërsa në rast kur kryhet monitorimi i brendshëm, gjobat arrijnë një vlerë nga 6000 euro. Në fund, kur objektet, impiantet dhe instalimet e numëruara më herët ndotin mjedisin jetësor jashtë vlerave kufizuese të përcaktuara me ligj, atëherë dënimi mund të arrijë dhe deri 100 000 euro. Në të tre rastet, Ligji parasheh gjobë financiare si për personin përgjegjës, ashtu dhe për personin juridik.



Aktivitetet e ardhshme për implementimin e Protokollit RLBN në Republikën e Maqedonisë

Zhvillimi i kornizës institucionale

Gjatë analizës së kornizës ekzistuese institucionale për zbatimin e obligimeve që dalin nga Protokollit RLBN, fokusi është vënë mbi institucionet që disponojnë me informacionet relevante mbi mjedisin jetësor, dhe institucionet janë përgjegjëse për sjelljen e vendimeve, planifikimin dhe formulimin e politikave lidhur me mjedisin jetësor. Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor është organi kompetent i administratës shtetërore i cili sjell dhe zbaton politikën e mbrojtjes së mjedisit jetësor dhe natyrës. Organet tjera që kanë kompetenca në lëmin e mbrojtjes së mjedisit jetësor janë:

Ministria e Ekonomisë,

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave,

Ministria e Shëndetësisë, dhe

Ministria e Transportit dhe Lidhjeve.

Koordinimi midis institucioneve që kryejnë monitorim nuk është në nivel të kënaqshëm dhe kështu, nevojitet vendosja e një programi kombëtar gjithëpërfshirës për monitorimin e mjedisit jetësor, me përfizim të qartë të kompetencave midis institucioneve që kryejnë monitorimin, si dhe të objektivave dhe metodologjive të harmonizuara. Gjithashtu, pajisja me të cilën disponojnë institucionet nuk është nga ajo më moderne dhe kjo gjë rezulton me marrjen dhe procesimin e të dhënave jopërkatese dhe jocilësore, dhe kështu del nevoja për furnizimin e pajisjes më moderne për të vendosur një monitorim të vazhdueshëm, si dhe modelim dhe zhvillim të sistemit informativ kombëtar. Monitorimi është vendosur brënda një kuadri përkatës të çështjeve ligjore, institucionale dhe teknike në Strategjinë Kombëtare për Monitorimin e Mjedisit Jetësor, e cila paraqet një skicë të përpunuar të sistemit për monitorimin e mjedisit jetësor, duke përfshirë këtu dhe planifikimin me të cilin do të ishte zhvilluar dhe përmirësuar monitorimi i cilësisë së mjedisit jetësor (uji, ajri, dheu, natyra dhe zhurma), si dhe monitorimi i emetimeve, e sidomos i ujërave të zeza, gazrave nxjerrëse, zhurmës dhe mbeturinave.

Procesi i filluar i afrimit dhe transponimit të acquis evropiane dhe atë të Maqedonisë duhet të intensifikohet, duke mbajtur llogari gjatë kësaj që procesi të rezultojë me përcaktimin e qartë dhe pozicionimin e kompetencave për mbrojtjen e mjedisit jetësor midis institucioneve shtetërore, gjë kjo e cila do të çojë drejt zbatimit të plotë dhe efikas të ligjeve, koordinimit inter dhe intra sektorial si dhe aplikimit të plotë të Protokollit RLBN, si një nga shtyllat e Konventës së Aarhusit në praktikë. Për aplikimin e Protokollit është shumë me rëndësi të punohet në drejtim të fuqizimit të sistemit për parandalim dhe kontroll të integruar të Ndotjes.



Fuqizimi i kapaciteteve administrative në administrimin e mjedisit jetësor

Në pajtim me ligjet e miratuara nga lëmi i mjedisit jetësor, komunat marrin kompetenca të reja për mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe natyrës.

Për decentralizim të plotë dhe të suksesshëm të mjedisit jetësor, nevojitet fuqizimi i kornizës institucionale për planifikim, monitorim dhe zbatim të rregullave ekologjike në nivelin lokal.

Për këtë qëllim, nevojitet sigurimi i resurseve financiare për zbatim efikas të obligimeve që dalin nga legjislacioni kombëtar për mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe diseminimit të të dhënave, informacioneve, hapjes dhe pajisjes së pikave informative për rëndësinë e ruajtjes së mjedisit jetësor.

Një nga lëmet ku duhet intervenuar, për të siguruar kushte për zbatim efikas të Protokollit RLBN është fuqizimi i kapaciteteve të institucioneve që janë përgjegjëse për zbatimin e Protokollit.

Gjithë institucionet kompetente, operatorët, njësitë e vetëqeverisjes lokale dhe organizatat joqeveritare duhet të inkuadrohen në trajnimin mbi aplikimin e Protokollit RLBN.

Duke ditur faktin se objektivi elementar i këtij Protokollit është vendosja e regjistrave konzistente, të integruara kombëtare për lëshimin dhe bartjen e materjeve ndotëse, të cilat mund të sigurojnë:

- përmirësimin e qasjes së publikut në informacione,
- pjesëmarrjen e publikut në vendimsjellje në lëmin e mjedisit jetësor,
- parandalimin dhe pakësimin e ndotjes së mjedisit jetësor,
- ndjekjen e përshtatjes me marrëveshje të caktuara ndërkombëtare, si dhe
- vendosjen e prioriteteve dhe vlerësimin e progresit të arritur nëpërmjet të programeve dhe politikave kombëtare.

Aktivitetet për aplikimin e suksesshëm dhe efikas të Protokollit RLBN në praktikë duhet të jenë të orientuara drejt fuqizimit të kapaciteteve administrative, të të gjithë vepruesve shoqëror, përfshirë këtu dhe institucionet, organizatat joqeveritare dhe operatorët. Me këtë, duhet orvatur për plotësim konzistent të objektivave të lartëpërmendur, me realizimin e aktiviteteve në vijim:

- Fuqizimi i kapaciteteve administrative në procesin e raportimit, administrimit dhe përdorimit të aplikimit softuerik nga baza RLBN,
- Mundësimi i masave për mbështetjen e studimeve, programeve dhe projekteve arsimore, hulumtuese dhe zhvillimore për mbrojtjen dhe avancimin e mjedisit jetësor dhe natyrës, e ngjashëm,
- Krijimi dhe realizimi i programit për koordinim dhe bashkëpunim ndër-institucional,
- Realizimi i fushatave për ngritjen e vetëdijes publike mbi mjedisin jetësor,
- Zhvillimi i kapaciteteve të institucioneve dhe organeve lokale,
- Zbatimi i një programi trajnues për industrinë dhe organizatat joqeveritare,
- Bashkëpunimi i vazhdueshëm me organet e organizatave dhe institucioneve ndërkombëtare.

Në procesin e vendosjes dhe mbajtjes së regjistrave, është i domosdoshëm grumbullimi dhe administrimi i centralizuar i të dhënave. Validizimi i të dhënave mund të arrihet më lehtë nëse u delegohet



organeve lokale ose nacionale, pasi ata do të jenë më afër me operatorët dhe kapacitetet dhe ka më shumë gjasa që të kenë pasqyrë më të mirë të aktiviteteve të tyre. Një nga mënyrat e mundshme për validizimin e të dhënave është të shfrytëzohen informacionet nga kontrollet e tjera të kryera të instalimeve, për shembull, nëpërmjet të inspektimeve të rregullta ose të jashtëzakonshme. Duke ditur se ekziston mungesa e stafit të kualifikuar për plotësim të suksesshëm dhe të plotë të obligimeve që dalin nga Protokollin RLB, nevojitet fuqizimi i kapaciteteve në nivelin lokal në lidhje me planifikimin, monitorimin dhe zbatimin e rregullave ekologjike në nivelin lokal.

Zhvillimi i veglave elektronike

Gjatë analizës së sistemit informativ kombëtar për mbrojtjen dhe avancimin e mjedisit jetësor, organi kompetent për themelimin dhe administrimin e tij, dhe me qëllim mbrojtja e mjedisit jetësor në pajtim me Ligjin për Mjedis Jetësor, është Qendra Informative Maqedonase për Mjedisin Jetësor. Me këtë, është konstatuar se për aplikimin e suksesshëm të regjistrave, në pajtim me kërkesat e Protokollit për përpilimin e dokumenteve të cilat do të kenë për qëllim parandalimin dhe pakësimin e ndotjes së mjedisit jetësor, ndjekjen e përshtatjes me marrëveshjet e caktuara ndërkombëtare, si dhe vendosjen e prioriteteve dhe vlerësimin e progresit të arritur nëpërmjet të programeve dhe politikave nacionale, nevojitet që të ndërmerren aktivitetet në vijm:

- Azhurnimi i bazës ekzistuese elektronike, e cila mundëson zbatimin e procedurës për raportim intern midis operatorëve dhe institucioneve kompetente, përfshirë këtu dhe aplikimin online, cilësinë dhe kontrollin e të dhënave, gjenerimin e raporteve dhe konektimin me shtresat GIS, si dhe, natyrisht, qasjen e publikut dhe palëve të ndryshme të interesuara, nëpërmjet të formatit të bazuar mbi uebin;
- Përpilimi i një Udhëzuesi për operatorët për raportim online mbi RLB dhe diseminimi i tij i gjerë;
- Rrumbullakësi i procesit të emërimit të personave përgjegjës nga operatorët që do të jenë përgjegjës për grumbullimin, validizimin dhe raportimin në pajtim me kërkesat e Protokollit;
- Regjistrimi online i gjithë instalimeve RLB në Republikën e Maqedonisë;
 - Publikimi i të dhënave të procesuara që janë marrë nga baza RLB, në portalin e internetit, në të cilin të dhënat do të bëhen të disponueshme në formën e raporteve dhe broshurave.



Diseminimi i të dhënave

Në pajtim me Strategjinë e Administrimit të të Dhënave mbi Mjedisin Jetësor, është vendosur korniza për zhvillimin e sistemit informativ kombëtar për mjedisin jetësor nga aspekti teknik, teknologjik dhe institucional, me qëllim të fundit – rritja e efikasitetit gjatë administrimit të të dhënave, gjegjësisht, sigurimi me kohë i të dhënave të cilësisë së lartë, relevante dhe objektive mbi mjedisin jetësor, për grupe dhe shfrytëzues të ndryshëm qëllimorë.

Ndërkaq, sigurimi i qasshmërisë së të dhënave RLBN nuk nënkupton vetëm qasje fizike në informacion, por dhe prezantimi i atij informacioni në formën që kuptohet lehtë dhe është e lehtë për ta përdorur. Në kontekstin e qasshmërisë, regjistri kombëtar është i lehtë për ta gjetur; publiku mund ta gjejë lehtë informacionin përkatës në regjistrin për të cilin ekziston interesi, ndërsa informacioni i tillë është prezantuar në mënyrë e cila është e kuptueshme.

Megjithatë, në Republikën e Maqedonisë ekziston nevoja urgjente për zhvillimin dhe zbatimin e programit afatgjatë për informim dhe edukim të qytetarëve, dhe për këtë qëllim duhet vendosur sisteme të tilla, ku informacionet RLBN janë diseminuar dhe janë të qasshme lehtë dhe janë të orientuar drejt shfrytëzuesve të ueb faqeve.

Bashkëpunimi me organizatat joqeveritare dhe vepruesit tjerë

Bashkëpunimi me organizatat joqeveritare dhe vepruesit tjerë ka rëndësi vendimtare për zbatimin e plotë dhe përkatës të të gjitha obligimeve që dalin nga dispozitat e përmbajtura në Protokollin e RLBN-së. Bashkëpunimi me të gjithë vepruesit është njëkohësisht dhe obligim dhe e drejtë për të gjithë palët e interesuara. Kështu, rekomandohet që në vijë me bashkëpunimin tanimë të vendosur në kuadër të Grupit të Punës e cila deri tani vepron si pjesë e organit koordinues në kuadër të MMJPH-së, që të vazhdohet, por dhe të zgjerohet anëtarësia në të, për të siguruar një përfaqësim sa më të gjerë gjatë zbatimit të aktiviteteve dhe obligimeve që dalin nga Protokollin.

Nga puna e Grupit të Punës për RLBN-në, duhet të del, para së gjithash, rritja e interesit tek publiku i gjerë për RLBN-në, dhe në të njëjtën kohë, të sigurohet dhe baza për organizimin e trajnimeve për shfrytëzim të informacioneve, si në nivelin teknik, ashtu dhe në nivelin e resurseve njerëzore.

Njëkohësisht, përveç mbajtjes së trajnimeve, një ndihmë përkatëse financiare për OJQ-të duhet të ndahet për zbatimin e aktiviteteve nga më të ndryshmet. Shembuj të aktiviteteve të OJQ-ve të cilat duhet të financohen janë: projektet pilot për OJQ-të, themelimi dhe mbajtja e ueb faqeve profesioniste të OJQ-ve, të cilat duhet të përmbajnë dhe baza të të dhënave përkatëse, organizimi i seminareve, punëtorive dhe konferencave, organizimi i fushatave për ngritjen e vetëdijes lidhur me shëndetin dhe mjedisin jetësor të të punësuarve në komplekset industriale por dhe të qytetarëve, me theks të veçantë mbi grupet e lëndueshme.



Ndërtimi i kapaciteteve të shfrytëzuesve të RLBN-së duhet ta fuqizojë bashkëpunimin e përgjithshëm midis sektorit joqeveritar dhe organeve dhe institucioneve shtetërore (përveç Grupit të Punës, të përmendur më lartë për RLBN) dhe sigurisht, t'i kushtohet një vëmendje e posaçme përcaktimit të rreziqeve që kanë të bëjnë me shëndetin dhe mjedisin jetësor, nëpërmjet të veglave, si dhe metodologjive administrative dhe modelimit të të dhënave mbi RLBN-në.

Edhe pse më lartë në këtë publikim është shënuar se deri tani janë hartuar katër strategji për zbatim adekuat dhe të plotë të Protokollit, propozohet përpilimi i strategjisë së re e cila do të jep një reflektim të posaçëm, në bazë të një analize gjithëpërfshirëse të gjendjes aktuale, si dhe në të gjitha hapat që duhet të ndërmerren nga institucionet kompetente për fuqizimin e bashkëpunimit me OJQ-të dhe vepruesit tjerë, por jo si një qëllim në vete, por me synim të gjetjes së mekanizmave përkatëse për zbatim të Protokollit.



SHTOJCA I



2011027698

MINISTRIA E MJEDISIT JETËSOR DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR

Në bazë të Nenit 41 paragrafit (2) të Ligjit mbi Mjedisin Jetësor (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 53/05, 81/05, 24/07, 159/08, 83/09, 48/10 dhe 124/10), Ministri i Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, solli

RREGULLORE PËR FORMËN, PËRMBAJTJEN, METODOLOGJINË DHE MËNYRËN E MBAJTJES SË REGJISTRIT TË LËSHIMIT DHE BARTJES SË NDOTËSVE

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Me këtë Rregullore përcaktohet forma, përmbajtja, metodologjia dhe mënyra e mbajtjes së Regjistrit të lëshimit dhe bartjes së ndotësve.

Neni 2

Regjistri i lëshimit dhe bartjes së ndotësve mbahet me qëllim sigurimi i qasjes më të lehtë të publikut në informacione, nga lëmi i mjedisit jetësor, të cilat janë të qasshme dhe të azhurnuara në faqen e internetit të Ministrisë së Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, si dhe me ndihmën e mjeteve tjera elektronike.

Neni 3

Disa shprehje të caktuara në kuptimin e kësaj Rregulloreje kanë domethënien ni vijim:

1. “organ kompetent” është Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor;
2. “veprimtari” është një proces ose çfarëdo aktiviteti tjetër i shënuar në Shtojcën 1 të kësaj Rregulloreje në bazë të së cilës vjen deri tek lëshimi dhe bartja e ndotësve në ajër;

3. “i detyruar për dërgim të informacioneve” është operatori i instalimit dhe personi përgjegjës tek operatori i cili kryen funksionet nga Shtojca 1 e kësaj Rregulloreje dhe/ose çfarëdo funksioni ose aktiviteti tjetër të trajtimit të mbeturinave;
4. “implant” do të thotë një ose më tepër njësi teknologjike në të njëjtën vendodhje, apo në të njëjtin instalim me të cilin operon personi fizik ose juridik;
5. “pragu i lëshimit” është sasia e lëshimit të ndotësve të përcaktuar në Shtojcën 2 të kësaj Rregulloreje për të cilat dërgohen informacione vetëm në rast kur pragu kalohet;
6. “kapacitet” është vlera e projektuar e implantit, e cila jep mundësi zbatimi të një veprimtarie të caktuar nga Shtojca 1 të kësaj Rregulloreje;
7. “vendbanim” është pozicionimi gjeografik i implantit;
8. “substancë” është secili element kimik ose përzierjet e tij, me përjashtim të substancave radioaktive;
9. “ndotës” është materje ose substancë ndotëse ose grup të substancave të cilat mund të jenë të dëmshme për mjedisin jetësor ose për shëndetin e njerëzve për arsye të veçorive të tyre dhe futjes së tyre në mjedisin jetësor dhe janë përcaktuar me Shtojcën 2 të kësaj Rregulloreje;
10. “lëshim” është çdo futje e ndotësve në mjedisin jetësor si rezultat i cilitdo aktivitet njerëzor, i qëllimshëm apo i paqëllimshëm, rutinor ose jorutinor, duke përfshirë këtu derdhjen, emetimin, zbrazjen, injektimin, nxjerrjen ose deponimin, ose nëpër sistemet e kanalizimit pa pastrim përfundimtar të ujërave të zeza;
11. “bartje jashtë vendndodhjes” është nxjerrja e mbeturinave të menduara për riciklim ose deponim dhe të ndotësve në ujërat e zeza, e menduar për pastrim jashtë kufijve të implantit;
12. “mbeturinë” është çdo substancë ose objekt në pajtim me rregullat mbi mbeturinat;
13. “mbeturinë e rrezikshme” është çdo substancë ose objekt sipas rregullave mbi mbeturinat;
14. “ujëra të zeza” janë ujërat e zeza të përkufizuara konform rregullave mbi ujërat;
15. “deponim” është cilitdo nga aktivitetet e përcaktuara me rregullat mbi mbeturinat;
16. “D2” është operacioni për magazinim i cili shënon grykëderdhje të thellë (grykëderdhje të nxjerrjeve të pompave në pus, kupolave kripore ose vendpastrimeve të natyrshme) konform Ligjit mbi Ratifikimin e Konventës së Bazelit për Kontrollin e Bartjes Ndërkufitare të mbeturinave të rrezikshme dhe magazinimin e tyre (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 49/97).

17. “D3” është operacioni i magazinimit i cili shënon mbylljen sipërfaqësore (vënia e mbeturinave të lëngshme ose të qullëta në gropa, liqene artificiale ose laguna), në pajtim me Ligjin mbi Ratifikimin e Konventës së Bazelit për Kontrollin e Bartjes Ndërkufitare të mbeturinave të rrezikshme dhe magazinimin e tyre (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 49/97);

18. “riciklimi” është cildo nga aktivitetet e përcaktuara në rregullat mbi mbeturinat; dhe

19. “shënim” në kuptimin e kësaj Rregulloreje janë të dhënat në bazë të të cilave operatori kryen dhe kumton informacionet deri tek organi kompetent, në të cilin është përmbajtur dhe metodologjia e përdorur për llogaritjen e të dhënave.

FORMA E REGJISTRIT

Neni 4

(1) Regjistri i lëshimit dhe bartjes së ndotësve (në tekstin e mëtejshëm referuar si: Regjistër i ndotësve) përdoret në formën e aplikacionit të programuar elektronik (softuer) i cili mundëson futje të rrjetëzuar, procesim dhe prezantim të të dhënave në regjistër në mënyrë të procesuar dhe joprocesuar dhe mundëson kërkimin e tyre.

(2) Forma e Regjistrit të ndotësve është skicuar në mënyrë e cila mundëson qasje në aplikacionin e programuar elektronik nga paragrafi (1) të këtij Neni, nëpërmjet të internetit, me përdorim të emrit të shfrytëzuesit dhe fjalëkalimit dhe ruajtje të të dhënave për një periudhë 10-vjeçare.

PËRMBAJTJA E REGJISTRIT

Neni 5

Regjistri i ndotësve përmban të dhëna mbi:

- instalimin së bashku me gjithë impiantet në të dhe pozicionimin e tij gjeografik, përfshirë këtu dhe basenin lumor në të cilin gjendet;
- operatorin e instalimit të angazhuar për dërgim të të dhënave;
- veprimtaritë e instalimit;
- lëshimin e ndotësve në mediat e mjedisit jetësor (ajër, ujë dhe dhé);
- krijimin dhe bartjet e mbeturinave jashtë vendndodhjes dhe destinacioni i tyre, ashtu siç është e përshtatshme; dhe
- bartjet e ujërave të zeza jashtë vendndodhjes.

Neni 6

(1) Veprimtaritë që janë arsyeja e krijimit dhe lëshimit të ndotësve dhe bartjes jashtë vendit të shfaqjes së ndotjes, kodi dhe kapaciteti i tyre janë shënuar në Shtojcën 1 e cila është pjesë përbërëse e kësaj Rregulloreje.

(2) Ndotësit që lëshohen në ajër, ujë dhe dhé dhe transmetohen jashtë vendit të shfaqjes së ujërave të zeza, kodi i tyre dhe numrat regjistruar (CAS – Chemical Abstract Service) dhe pragjet e lëshimit janë dhënë në Shtojcën 2 e cila është pjesë përbërëse e kësaj Rregulloreje.

METODOLOGJIA E MBAJTJES SË REGJISTRIT

Neni 7

(1) Organi kompetent kujdeset për plotshmërinë dhe besueshmërinë e të dhënave të përmbajtura në Regjistrin e ndotësve, si dhe për kontrollin e cilësisë dhe sigurimit të cilësisë së të dhënave në Regjistrë.

(2) Organi kompetent përkujdeset për mbrojtjen e të dhënave të posaçme nga Regjistri i ndotësve vetëm nëse operatori i instalimit deri tek organet kompetente dërgon akte me të cilat është përcaktuar besueshmëria e atyre të dhënave.

(3) Gjatë dërgimit të të dhënave dhe informacioneve deri tek organi kompetent, operatori shfrytëzon informacionet më të mira në dispozicion, të cilat mund të përfshijnë të dhëna, faktorë të emetimit, ekuacione të balancit të masës, ndjekje të tërthortë dhe llogaritje tjera, mendime inxhinierike dhe metoda tjera, në pajtim me metodologjitë ndërkombëtarisht të miratuara, të cilat janë vënë në dispozicion.

(4) Operatori i secilit instalim i shënuar në Shtojcën 1 të kësaj Rregulloreje, mban llogari për plotshmërinë, qëndrueshmërinë dhe besueshmërinë e të dhënave dhe informacioneve që i dërgon deri tek organi kompetent.

MËNYRA E MBAJTJES SË REGJISTRIT

Neni 8

(1) Organi kompetent për nevojat e Regjistrit të ndotësve një herë në vit nga kadastrat e mjedisit jetësor duhet grumbulluar të dhënat dhe informacionet nga operatorët të secilit instalim që kryen një apo më tepër veprimtari të përcaktuara me Shtojcën 1 të kësaj Rregulloreje.

(2) Operatori i secilit instalim që kryen një apo më shumë nga veprimtaritë e përcaktuara me Shtojcën 1 të kësaj Rregulloreje, deri në fund të muajit mars të vitit aktual, deri tek organi kompetent dërgon në formë elektronike dhe të shkruar të dhënat dhe informacionet vijuese për vitin paraparak:



- lëshimi në ajër, ujë dhe dhé të cilitdo ndotës të përcaktuar në Shtojcën 2 të kësaj Rregulloreje e cila është pjesë përbërëse e kësaj Rregulloreje, për të cilin është tejkaluar pragu i përcaktuar në Shtojcë;

- krijimi dhe transmetimi jashtë vendit të krijimit të mbeturinave të rrezikshme dhe/ose të jorrezikshme, për riciklim ose deponim, me përjashtim të deponimit me pastrimin e dheut dhe injektimin e thellë, në pajtim me Ligjin për Administrimin e Mbeturinave, duke shënuar me “R” ose “D” përkatësisht, varësisht nga ajo nëse mbeturina është menduar për riciklim ose deponim, dhe për lëvizje ndërkufitare të mbeturinave të rrezikshme, emri dhe adresa e operatorit që kryen riciklimin ose deponimin e vendndodhjes ku do të bëhet riciklimi ose deponimi; dhe

- krijimi i nxjerrjes së ndotësve në ujërat e zeza të menduar për përpunim të mëtejshëm, prodhim dhe/ose bartje jashtë vendit të krijimit, për të cilat është tejkaluar pragu i përcaktuar me Shtojcën 2 të kësaj Rregulloreje.

(3) Të dhënat dhe informacionet nga paragrafi (2) i këtij Neni dërgohen së bashku me shënimin nëse janë ato të dhënat dhe informacionet që janë siguruar me matje, llogaritje ose vlerësim.

(4) Të dhënat dhe informacionet nga paragrafi (2) alinea 1 e këtij Neni dërgohen kur sasia e përgjithshme e lëshimit të ndotësve në nivelin vjetor, nga Shtojca 2 të kësaj Rregulloreje tejkalon prapun e përcaktuar me atë Shtojcë.

(5) Kur bëhet fjalë për të dhënat për të cilat nuk është shënuar se bazohen në matje ose llogaritje, detyrueshëm shënohet metoda analitike dhe/ose metoda e llogaritjes.

(6) Të dhënat të cilat operatori ia dërgon organit kompetent duhet qenë të plota, të qëndrueshme dhe të besueshme.

(7) Operatori, shënimet me të dhënat në bazë të të cilave janë nxjerrë të dhënat dhe informacionet që kishte dërguar organi kompetent duhet t'i ruajë për një periudhë nga pesë vjet nga dita e dërgimit të tyre.

Neni 9

Të dhënat dhe informacionet për lëshimin në dhé, operatori i instalimit brënda të cilit po krijohet mbeturina e cila trajtohet me një procedurë të përpunimit të mbeturinës ose me procedurë të injektimit të thellë siç janë operacionet D2 dhe D3, në pajtim me rregullat mbi mbeturinat, i dërgon deri tek organi kompetent konform rregullave për kadastrin e krijuesve të mbeturinave.

Neni 10

(1) Të dhënat nga Neni 8 të kësaj Rregulloreje përfshijnë të dhënat mbi lëshimin dhe bartjen jashtë vendit të krijimit, të cilat shfaqen si pasojë e gjithë aktiviteteve të qëllimshme, rutinë ose jorutinë në kuadër të një veprimtarie të caktuar.

(2) Kur bëhet fjalë për lëshimet e rastësishme, operatori numëron dhe të dhëna tjera të qasshme, që kanë të bëjnë me lëshimet e rastësishme.

Neni 11

Të dhënat nga Regjistri i ndotësve mbahet në mënyrë e cila siguron që ato do të bëhen publike në faqen e internetit, e sidomos të dhënat në vijim:

- identifikimi i instalimit;
- gjithë aktivitetet e instalimit nga Shtojca 1 të kësaj Rregulloreje;
- të dhënat mbi lëshimin e ajrit nga instalimi për çdo ndotës që tejkalon pragun e përcaktuar me Shtojcën 2 të kësaj Rregulloreje;
- bartjen jashtë vendndodhjes për çdo ndotës të menduar për pastrimin e ujërave të zeza në sasi që tejkalojnë pragun e shënuar në Shtojcën 2 të kësaj Rregulloreje;
- bartjen e mbeturinave të rrezikshme jashtë instalimit; dhe
- bartjen e mbeturinave të jorrezikshme jashtë instalimit.

DISPOZITA PËRMBYLLËSE

Neni 12

Kjo Rregullore hy në fuqi në ditën e publikimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë”, dhe do të aplikohet nga 1 janari i vitit 2013.

Nr. 07-28/6
15 shkurt viti 2011

Ministër i Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor
d-r Nexhati Jakupi, n.d.

SHTOJCA 1

Veprimtaritë në bazë të të cilave vjen deri tek krijimi i lëshimit të ndotësve dhe bartjes jashtë vendit të krijimit të ndotjes.

Nr.	Veprimtaritë	Pragu i kapacitetit
1.	Sektori energjetik	
(a)	Rafinieritë e vajit mineral dhe gazit	*
(b)	Instalimet për gazifikim dhe rrjedhje	*
(c)	Termocentralet	Me ngrohtësi të hyrjes nga 50 megavat (MW)
(ç)	Furra për koks	*
(d)	Makina petëzimi për thëngjill	Me kapacitet nga 1 ton për orë
(dh)	Instalime për prodhimin e produkteve nga thëngjilli dhe karburantit pa tym në gjendje të fortë agregate	*
2.	Prodhimi dhe përpunimi i metaleve	

(a)	Instalime për pjekjen ose skorjen e xeheve metalike (përfshirë këtu dhe xehet sulfide)	*
(b)	Instalime për prodhimin e hekurit të papërpunuar ose çelikut (shkrirje primare ose sekondare) përfshirë këtu dhe derdhje	Me kapacitet nga 2,5 tonë për orë
(c)	Instalime për përpunimin e metaleve në bazë të hekurit: (I) makina të ngrohta petëzimi (II) (farka) kovaçana me çekanë (III) përdorimi i mbështjellsave mbrojtëse metalike të shkrira	Me kapacitet nga 20 tonë të çelikut të papërpunuar për orë Me energji nga 50 kiloxhaul për çekan, ku fuqia ngrohëse e përdorur tejkalon 20 MW Me lëndë të parë hyrëse nga 2 tonë të çelikut të papërpunuar
(ç)	Hekurishte për metale në bazë të hekurit	Me kapacitet prodhues nga 20 tonë për ditë
(d)	Instalimet: (I) për prodhimin e metaleve të papërpunuara nga mineralet që bazohen në hekur, koncentre ose lëndë të para sekondare me procese metalurgjike, kimike ose elektrolite (II) për shkrirjen, përfshirë këtu dhe bërjen e fuzioneve, me metale që nuk janë bazuar në hekur, përfshirë këtu dhe produktet e ricikluara (rafinimi, derdhja në hekurishte, etj.)	* Me kapacitet për shkrirje nga 4 tonë për ditë për plumb dhe kadmium ose 20 tonë për ditë për gjithë metalet tjera
(dh)	Instalimet për përpunim sipërfaqësor të metaleve dhe materialeve plastike me shfrytëzimin e proceseve elektrolite ose kimike	Kur volumi i vaskave për përpunim arrin 30 m ³
3.	Industria xeherore	
(a)	Aktivitetet nëntokësore xeherore dhe të ngjashme	*
(b)	Nxjerrja sipërfaqësore e xeheve dhe gurrit	Kur sipërfaqja e zonës që është nën gjermim arrin 25 hektarë
(c)	Instalime për prodhimin e: (I) zgjyrë çimentoje në furra rrotulluese (II) gëlqere në furra rrotulluese (III) zgjyrë çimentoje ose gëlqere në furra tjera	Me kapacitet prodhimi nga 500 tonë për ditë Me kapacitet prodhimi nga 50 tonë për ditë Me kapacitet prodhimi nga 50 tonë për ditë
(ç)	Instalime për prodhimin e asbestit dhe prodhimin e produkteve të bazuara në asbest	*

(d)	Instalime për prodhimin e qelqit, përfshirë dhe leshin e xhamit	Me kapacitet për shkrirje nga 20 tonë për ditë
(dh)	Instalime për shkrirjen e substancave minerale, përfshirë dhe prodhimin e fibreve minerale	Me kapacitet për shkrirje nga 20 tonë për ditë
(e)	Instalime për prodhimin e produkteve qeramike me djegie, më konkretisht tjeçulla, pllaka, gurr stolitës ose porcelan	Me kapacitet prodhimi nga 75 tonë për ditë ose me furrë me kapacitet nga 4 m ³ dhe me dendësi të ndezjes nga 300 kg/m ³ për furrë
4.	Industria kimike	
(a)	Instalime kimike me volum industrial për prodhimin e kemikaljeve elementare organike, siç janë: (I) karbohidratet e rëndomta (lineare ose ciklike, të ngopura ose të pangopura, alifatike ose aromatike) (II) karbohidrate që përmbajnë oksigjen, siç janë alkoolët, aldehidet, ketonët, acidet karboksile, esteret, acetatet, eteret, peroksidët, rrëshira epoksike (III) karbohidrate squfuri (IV) karbohidrate azoti siç janë aminet, amidet, shkrirjet azotike, shkrirjet e azotit ose nitratet, nitrilet, cianatet, izocianatet (V) karbohidratet që përmbajnë fosfor (VI) karbohidratet halogjene (VII) shkrirjet organometale (VIII) materialet plastike elementare (polimerë, fibra sintetike dhe fibra të bazuara në celulozë) (IX) goma sintetike (X) ngjyra dhe pigmente (XI) agjense dhe surfakante aktive në sipërfaqe	*

(b)	Instalime kimike nga volumi industrial për prodhimin e kemikaljeve joorganike, siç janë: (I) gazrat, siç janë amoniumi, klori ose kloro-hidrogjeni, fluori, ose fluoro-hidrogjeni, oksidet e karbonit, shkrirjet e squfurit, oksidet e azotit, hidrogjeni, squfur dyoksidi, karbonil kloridet (II) acidet, siç janë acidi krom, acidi fluoro-hidrogjen, acidi fosfor, acidi i azotit, acidi kloro-hidrogjen, oleumi, acidi squfuri (III) bazat, siç janë amonium-hidroksidi, kalium-hidroksidi, natrium-hidroksidi (IV) kripërat, siç janë amonium-kloridi, kalium-klorati, kalium-karbonati, natrium-karbonati, perborati, argjend-nitrati (V) jometalet, oksidet metalike dhe shkrirjet tjera joorganike, siç janë kalci-um-karbidi, silikoni, silikon-karbidi	*
(c)	Instalime kimike me volum industrial për prodhimin e plehrave artificiale të bazuara në fosfor, azot ose kalium (plehra artificiale të thjeshta ose të përbëra)	*
(ç)	Instalime kimike me volum industrial për prodhimin e produkteve elementare për shëndetin e bimëve ose biocideve	*
(d)	Instalime me volum industrial që përdorin procese kimike ose biologjike për prodhimin e produkteve elementare farmaceutike	*
(dh)	Instalime me volum industrial për prodhimin e lëndëve plasëse dhe produkteve piroteknike	*
5.	Administrimi i mbeturinave dhe ujërave të zeza	
(a)	Instalime për riciklimin ose deponimin e mbeturinave të rrezikshme	Që marrin 10 tonë për ditë
(b)	Instalime për ndezjen dhe djegien e mbeturinave të parrezikshme konform Ligjit për Administrimin e Mbeturinave	Me kapacitet nga 3 tonë për orë

(c)	Instalime për deponimin e mbeturinave të jorrezikshme	Me kapacitet nga 50 tonë për ditë
(ç)	Depo (duke përjashtuar depotë për mbeturina inerte)	Që marrin 10 tonë për ditë dhe me kapacitet të përgjithshëm nga 25.000 tonë
(d)	Instalime për deponimin ose riciklimin e trupave të kafshëve të ngordhura dhe mbeturinat nga kafshët	Me kapacitet përpunimi nga 10 tonë për ditë
(dh)	Stacione pastrimi të ujërave të zeza nga zonat urbane	Me kapacitet ekuivalent për popullatë nga 100.000 banorë
(e)	Stacione pavarësisht të administruara për ujëra të zeza industriale, që shërbejnë për një apo më tepër aktivitete nga kjo shtojcë	Me kapacitet nga 10.000 m ³ në ditë (4)
6.	Prodhim dhe përpunim të letrës dhe drurit	
(a)	Impiante industriale për prodhimin e pulpës nga lënda e drurit ose nga materiale të ngjashme fibroze	*
(b)	Bimë industriale për prodhimin e letrës dhe pllakave për ngrohje dhe produkte tjera primare nga druri (siç janë ashkla, mediapani dhe kompensata)	Me kapacitet prodhimi nga 20 tonë për ditë
(c)	Impiante industriale për mbrojtjen e drurit dhe produkte nga druri me kemikalje	Me kapacitet prodhimi nga 50 m ³ për ditë
7.	Prodhim intensiv të bagëtisë dhe peshqëve dhe guacave	
(a)	Instalime për ruajtje intensive të shpendëve dhe derrave	(I) me 40.000 vende për shpendët (II) me 2.000 vende për derra prodhues (mbi 30 kg) (III) me 750 vende për dose
(b)	Ruajtje intensive të peshqëve dhe guacave	Me kapacitet prodhimi nga 1.000 tonë peshk ose guaca në vjet
8.	Prodhime nga kafshët ose të perimeve nga sektori i ushqimit dhe pijeve	
(a)	Thertore	Me kapacitet prodhimi të trupave nga 50 tonë për ditë
(b)	Procesimi dhe përpunimi të menduar për prodhimin e produkteve ushqimore dhe pijeve nga: (I) lëndë të para të kafshëve (përveç qumështit) (II) lëndë të para të perimeve	Me kapacitet prodhimi për produktet finale nga 75 tonë për ditë Me kapacitet prodhimi për produktet finale nga 300 tonë për ditë (vlera mesatare për tremujor)

(c)	Procesimi dhe përpunimi i qumështit	Me kapacitet për të marrë 200 tonë qumësht për ditë (vlera mesatare në bazë vjetore)
9.	Aktivitete tjera	
(a)	Bimë për procesim paraprak (aktivitete siç janë larja, zbardhja, mercenizimi) ose ngjyrosje të fibrave ose tekstileve	Me kapacitet procesimi nga 10 tonë për ditë
(b)	Bimë për regji të lëkurave të papërpunuara dhe lëkurave	Me kapacitet përpunimi në 12 tonë të produkteve përfundimtare për ditë
(c)	Instalime për procesim sipërfaqësor të substancave, objekteve ose produkteve që përdorin tretës organik, sidomos për procesimin përfundimtar, shtypje, mbështjellje, mënjanim të yndyrërave, mbrojtje ujëmbrojtëse, lyerje me tutkal, ngjyrosje, pastrim ose impregnim	Me kapacitet nga 150 kg për orë ose 200 tonë në nivelin vjetor
(ç)	Instalime për prodhimin e karbonit (karbon i fortë i djegur) ose elektro-grafit me ndezje ose grafitizim	*
(d)	Instalime për ndërtim, ngjyrosje ose mënjanim të ngjyrës nga anijet	Me kapacitet për anije me gjatësi nga 100 metra
(1)	Asteriksi (*) shënon se nuk aplikohet pragu i kapacitetit (të gjitha impiantet janë lëndë e raportimit)	
(1) Asteriksi (*) shënon se nuk aplikohet pragu i kapacitetit (të gjitha impiantet janë lëndë e raportimit)		

SHTOJCA 2

Ndotësit1

Nr.	Nr. CAS	Ndotësi (1)	Pragjet e lëshimit (kolona 1)		
			në ajër (kolona 1a) kg/për vit	në ujë (kolona 1b) kg/për vit	në dhé (kolona 1c) kg/për vit
1	74-82-8	Metan (CH ₄)	100 000	~(2)	-
2	630-08-0	Monoksid kar- boni (CO)	500 000	-	-
3	124-38-9	Dyoksid kar- boni (CO ₂)	100 milionë	-	-
4		Hidro-fluor- karbon- hidrogjeni (HFC) (3)			
5	10024-97-2	Oksid azoti (N ₂ O)	10 000	-	-
6	7664-41-7	Amonium (NH ₃)	10 000	-	-
7		Përzierje or- ganike avul- luese pa metan (NMVOC)	100 000	-	-
8		Okside azoti (NO _x /NO ₂)	100 000	-	-
9		Perfluorkar- bone (PFC) (4)	100	-	-
10	2551-62-4	Squfur-hek- safluorid (SF ₆)	50	-	-
11		Okside squfuri (SO _x /SO ₂)	150 000	-	-
12		Azoti i përgjithshëm	-	50 000	50 000
13		Fosfori i përgjithshëm	-	5 000	5 000
14		Klorofluork- arbone hi- drogjeni (HCFC) (5)	1	-	-

15		Klorofluork- arbore (CFC) (6)	1	-	-
16		Halone (7)	1	-	-
17		Arsen dhe përzierje (si As) (8)	20	5	5
18		Kadmium dhe përzierje (si Cd) (8)	10	5	5
19		Krom dhe përzierje (si Cr) (8)	100	50	50
20		Bakër dhe për- zierje (si Cu) (8)	100	50	50
21		Zhivë dhe përzierje (si Hg) (8)	10	1	1
22		Nikel dhe përzierje (si Hi) (8)	50	20	20
23		Plumb dhe përzierje (si Pb) (8)	200	20	20
24		Zinc dhe për- zierje (si Zn) (8)	200	100	100
25	15972-60-8	Alaklor	-	1	1
26	309-00-2	Aldrin	1	1	1
27	1912-24-9	Atrazin	-	1	1
28	57-74-9	Klordan	1	1	1
29	143-50-0	Klordekon	1	1	1
30	470-90-6	Klorfenvinfos	-	1	1
31	85535-84-8	Kloroalkane (C10-C13)	-	1	1
32	2921-88-2	Kloropirifos	-	1	1
33	50-29-3	DDT	1	1	1
34	107-06-2	1,2 dykloretan (EDC)	1 000	10	10

35	75-09-2	Dyklormetan (DCM)	1 000	10	10
36	60-57-1	Dyeldrin	1	1	1
37	330-54-1	Dyuron	-	1	1
38	115-29-7	Endosulfan	-	1	1
39	72-20-8	Endrin	1	1	1
40		Përzierje organike halogjene (si AOX) (9)	-	1 000	1 000
41	76-44-8	Heptaklor	1	1	1
42	118-74-1	Heksaklorobenzen (HCB)	10	1	1
43	87-68-3	Heksaklorobutadien (HCBd)	-	1	1
44	608-73-1	1,2,3,4,5,6-Heksaklorocikloheksan (HCH)	10	1	1
45	58-89-9	Lindan	1	1	1
46	2385-85-5	Mireks	1	1	1
47		PCDD + PCDF (dyoksine + furane) (si Teq) (10)	0,0001	0,0001	0,0001
48	608-93-5	Pentaklorobenzen	1	1	1
49	87-86-5	Pentaklorofenol (PCP)	10	1	1
50	1336-36-3	Bifenile të polikloruara (PCB)	0,1	0,1	0,1
51	122-34-9	Simazin	-	1	1
52	127-18-4	Tetrakloroetilen (PER)	2 000	10	-
53	56-23-5	Tetraklorometan (TCM)	100	1	-

54	12002-48-1	Trikloroben- zene (TCB) (gjithë izomerët)	10	1	-
55	71-55-6	1,1,1 – trik- loroetan	100	-	-
56	79-34-5	1,1,2,2 – tetrakloroetan	50	-	-
57	79-01-6	Trikloroetilen	2 000	10	10
58	67-66-3	Triklorometan	500	10	-
59	8001-35-2	Toksafen	1	1	1
60	75-01-4	Vinil klorid	1 000	10	10
61	120-12-7	Antracen	50	1	1
62	71-43-2	Benzen	1 000	200 (si BTEX) (11)	200 (si BTEX) (11)
63		Dyfeniletere të bromuara (PBDE) (12)	-	1	1
64		Nonilofenole dhe etoksilate nonifenole (NP/NPE)	-	1	1
65	100-41-4	Etilbenzen	-	200 (si BTEX) (n)	200 (si BTEX) (n)
66	75-21-8	Etilenoksid	1 000	10	10
67	34123-59-6	Izoproturon	-	1	1
68	91-20-3	Naftalen	100	10	10
69		Përzierje organotine (si Sn i përgjith- shëm)	-	50	50
70	117-81-7	Dy(2-etil heksil)ftalat (DEHP)	10	1	1
71	108-95-2	Fenole (si C i përgjithshëm) (13)	-	20	20
72		Hidrogjene karboni policiklike aromatike (PAH) (14)	50	5	5

73	108-88-3	Toluen	-	200 (si BTEX) (n)	200 (si BTEX) (n)
74		Tributiltin dhe përzierje (15)	-	1	1
75		Trifeniltin dhe përzierje (16)	-	1	1
76		Karbon i përgjithsëm organik (TOC) (si C i përgjithshëm ose COD/3)	-	50 000	-
77	1582-09-8	Trifluralin	-	1	1
78	1330-20-7	Ksilene (17)	-	50	50
79		Kloride (si C1 i përgjithsëm)	-	2 milionë	2 milionë
80		Klor dhe përzierje joorganike (si HC1)	10 000	-	-
81	1332-21-4	Asbest	1	1	1
82		Cianide (si CN i përgjithsëm)	-	50	50
83		Fluoride (si F i përgjithsëm)	-	2 000	2 000
84		Fluor dhe përzierje joorganike (si HF)	5 000	-	-
85	74-90-8	Cianide hidrogjeni (HCN)	200	-	-
86		Materje fisnike (PM10)	50 000	-	-
87	1806-26-4	Oktilofenole dhe etoksilate oktilofenole	-	1	-
88	206-44-0	Fluoranten	-	1	-
89	465-73-6	Izodrin	-	1	-
90	36355-1-8	Heksa-brombifenil	0,1	0,1	0,1
91	191-24-2	Benzo(g,h,i)pejlen		1	



(1) Përveç nëse nuk është shënuar ndryshe, për të cilin ndotës të përcaktuar me Shtojcën 2, raportohet si masë e përgjithshme e atij ndotësi, ose kur ndotësi është një grup substancash, si masë e përgjithshme e grupit.

(2) Viza (-) tregon se për këtë parametër dhe media nuk raportohet.

(3) Masa e përgjithshme e fluorokarbon hidrogjeni: shuma e HFC23, HFC32, HFC41, HFC-4310mee, HFC125, HFC134, HFC134a, HFC152a, HFC143, HFC143a, HFC227ea, HFC236fa, HFC245ea, HFC365mfc.

(4) Masa e përgjithshme e perfluorokarboneve: shuma e CF₄, S₂F₆, C₃F₈, C₄F₁₀, c-C₄F₈, C₅F₁₂, C₆F₁₄.

(5) Masa e përgjithshme e substancave që varfërojnë mbështjellësen e ozonit, përfshirë këtu dhe izomerët e tyre, si vijon: CHFCl₂, CHF₂Cl, CH₂FCl C₂HFCl₄, C₂HF₂Cl₃, C₂HF₃Cl₂, C₂HF₄Cl, C₂H₂FCl₃, C₂H₂F₂Cl₂, C₂H₂F₃Cl, C₂H₃FCl₂, CH₃CFCl₂, C₂H₃F₂Cl, CH₃CF₂Cl, C₂H₄FCl, C₃HFCl₆, C₃HF₂Cl₅, C₃HF₃Cl₄, C₃HF₄Cl₃, C₃HF₅Cl₂, CF₃CF₂CHCl₂, CF₂CICF₂CHClF, C₃HF₆Cl, C₃H₂FCl₅, C₃H₂F₂Cl₄, C₃H₂F₃Cl₃, C₃H₂F₄Cl₂, C₃H₂F₅Cl, C₃H₃FCl₄, C₃H₃F₂Cl₃, C₃H₃F₃Cl₂, C₃H₃F₄Cl, C₃H₄F₂Cl₂, C₃H₅FCl₂, C₃H₆FCl dhe C₃H₅F₂Cl.

(6) Masa e përgjithshme e substancave që varfërojnë mbështjellësen e ozonit përfshirë këtu dhe izomerët e tyre, si vijon: CFCl₃, CF₂Cl₂, C₂F₃Cl₃, C₂F₄Cl₂, C₂F₅Cl, CF₃Cl, C₂FCl₅, C₂F₂Cl₄, C₃FCl₇, C₃F₂Cl₆, C₃F₃Cl₅, C₃F₄Cl₄, C₃F₅Cl₃, C₃F₆Cl₂, C₃F₇Cl.

(7) Masa e përgjithshme e substancave që varfërojnë mbështjellësen e ozonit, përfshirë këtu dhe izomerët e tyre, si vijon: CF₂BrCl, CF₃Br, C₂F₄Br₂ dhe CCl₄.

(8) Për të gjitha metalet raportohet si masë të përgjithshme të elementit në të gjitha format kimike të pranishme gjatë lëshimit.

(9) Përzierjet organike të halogjenizuara të cilat mund të jenë të absorbuara me karbonin, të shprehura si klorid.

(10) Shprehur si I-TEQ.

(11) Ndotësit unik raportohen nëse tejkalohet pragu për BTEX (parametri i përmblodhur i benzenit, toluenit, etilbenzenit, ksilenit).

(12) Masa e përgjithshme e dyfenileterëve të bromuar: penta-BDE, okta-BDE dhe deka-BDE.

(13) Masa e përgjithshme e fenolit dhe fenolët unik të substituar, të shprehur si hidrogjen i përgjithshëm.

(14) Hidrogenet e karbonit policklik aromatik (PAH) maten për raportimin e lëshimit në ajër si benzo(a)piren (50-32-8), benzo(b)fluoranten (205-99-2), benzo(k)fluranten (207-08-9), indeno(1,2,3-cd)piren (193-39-5).

(15) Masa e përgjithshme e përzierjeve tributiltin, të shprehura si masë të tribultiltinit.

(16) Masa e përgjithshme e përzierjeve trifeniltin, të shprehura si masë të trifeniltinit.

(17) Masa e përgjithshme e ksilenit (orto-ksilen, meta-ksilen, para-ksilen).